



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 18 regjistër (JR)
Datë 24.05.2024

Nr. 93 i vendimit
Datë 16.12.2025

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 16.12.2025, ditën e martë, në orën 15:00 në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me sekretare gjyqësore Griselda Muça, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUESE: Komisionere Publike Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 738, datë 22.02.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Gëzim Çopa.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancat gjyqësore publike të zhvilluara në datat 05.11.2025, 05.12.2025 dhe 16.12.2025, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi pretendimet e ngritura në ankim nga Komisionerja Publike Irena Nino dhe konkluzionet përfundimtare të përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili përfundimisht kërkoi *ndryshimin* e vendimit nr. 738, datë 22.02.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, analizoi parashtrimet dhe konkluzionet e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi *lënien në fuqi* të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Gëzim Çopa (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe nenin 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Prokuroria e Përgjithshme.

2.1 ILDKPKI-ja dërgoi pranë Komisionit raportin përfundimtar¹ për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit: (i) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive; (iii) ka mosdeklarime ndër vite; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

2.2. DSIK-ja, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, ka përcjellë raportin e vlerësimit² përmes të cilit ka konkluduar *papërshtatshmëri* për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.

2.3. Prokuroria e Përgjithshme³ ka dërguar⁴ raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit; (ii) tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iv) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të kryer për të tria kriteret e rivlerësimit, pasi vlerësoi se subjekti *ka arritur nivel të besueshëm* për të trija kriteret e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të po këtij ligji, Komisioni, me shumicë votash⁵, vendosi *konfirmimin*

¹ Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë nr. {***} prot., datë 27.09.2018.

² Nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZh-së nr. {***}, datë 07.07.2023.

³ Në cilësinë e organit ndihmës të instiucioneve të rivlerësimit, deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me vendimin nr. {***}, datë 19.12.2018, të KLP-së.

⁴ Me shkresën nr. {***} prot., datë 18.12.2018.

⁵ Anëtarja Xhensila Pine ka dalë në mendim pakice, duke votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Në vlerësimin e saj, subjekti nuk ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke u gjendur në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Ndërsa në vlerësimin

në detyrë të subjektit të rivlerësimit, si edhe *transferimin* e dosjes së procedimit penal për të cilin kërkoi verifikim për inspektim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky vendim u bazua në vlerësimin përfundimtar për secilin kriter vlerësimi, si vijon.

3.1. Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm për kriterin *e vlerësimit të pasurisë*, pasi: (i) në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *vetting*, ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, në përputhje me pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës; (ii) ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ai nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij; (iii) pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve të rezultuara nuk janë të mjaftueshme për aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016; (iv) deklaratimet e pasakta dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare, nuk cenojnë kriterin e pasurisë apo figurën e prokurorit dhe besimin e publikut te drejtësia.

3.2. Ka arritur nivel të besueshëm në lidhje me kriterin *e kontrollit të figurës*. Gjatë hetimit administrativ, nuk u provua ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirja e subjektit në veprimtari të kundërligjshme.

3.3. Ka arritur nivelin kualifikues për kriterin *e vlerësimit të aftësive profesionale*. Komisioni nuk ka konstatuar shkelje të rënda procedurale, gabime thelbësore dhe serioze, apo një seri të gjykimeve të gabuara që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Për një prej procedimeve penale⁶, Komisioni vlerësoi se duhet bërë verifikim i detajuar mbi arsyet që e çuan subjektin e rivlerësimit në ndryshimin e cilësimit të veprës penale për dy të pandehur dhe kërkesën për pushimin e hetimeve për dy nga personat nën hetim.

III. Shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike

4. Komisionerja Publik Irena Nino ka ushtruar ankim duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 738, datë 22.02.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Sipas Komisioneres Publike në ankim, vendimi i Komisionit nuk është në pajtueshmëri me gjendjen e fakteve dhe provave të administruara në fashikull, të cilat nuk krijojnë bindjen që subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë, në kuptim të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016. Ankimi i Komisioneres Publike përfshin kriterin e kontrollit të pasurisë, atë të vlerësimit profesional dhe vlerësimin tërësor të çështjes, sipas shkaqeve të ankimit përmbledhur në vijim.

4.1. Në vlerësimin e Komisioneres Publike, subjekti i rivlerësimit *nuk* arriti nivel të besueshëm në kriterin *e vlerësimit të pasurisë*. Ai gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3 dhe neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Sipas ankueses, subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer *deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm* të pasurisë; (ii) *ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme* për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite. Ankimi ka për fokus disa aspekte të kontrollit të pasurisë e konkretisht:

tërësor, sipas mendimit të pakicës, subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

⁶ Dosja e procedimit penal nr. {***}/2019, me të pandehur M. A. etj.

4.1.1. Për të ardhurat e pretenduara nga marrëdhënia e qirasë dhe ajo e punësimit me shoqërinë “{***}” (referuar në vijim “{***}”), subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë përfitimin e tyre në kohën dhe shumën e pretenduar, dhe as shlyerjen e detyrimeve tatimore, si standard kushtetues i parashikuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, të ardhurat e pretenduara nga marrëdhënia e qirasë nuk duhen përfshirë në analizë financiare, për krijimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme, si dhe mbulimin e shpenzimeve ndër vite, ndërsa të ardhurat e pretenduara nga marrëdhënia e punësimit të subjektit me këtë shoqëri, duhet të konsiderohen deri në masën që provohet nga dokumentacioni i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

4.1.2. Për apartamentin e banimit me sipërfaqe prej 150,9 m² në Tiranë [i ndarë në dy apartamente] dhe tri garazhe, Komisionerja Publike pretendon se subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, për pamjaftueshmëri financiare në vlerën rreth 8,9 milionë lekë, të konstatuar fillimisht nga Komisioni. Sipas saj, rezultati financiar paraprak ndryshoi ndjeshëm në vlerësimin përfundimtar, për shkak të përfshirjes së disa të ardhurave të pretenduara nga subjekti, të cilat, sipas vlerësimit të ankueses, nuk duhen konsideruar si të ligjshme. Ankuesja kërkon të mos përfshihet si e ardhur e ligjshme shuma 47.000 euro, e pretenduar nga shitja e investimit të fushës së minifutbollit dhe as shuma 8.590.717 lekë nën zërin "të ardhura të mundshme të kursyera nga familja Çopa deri në datën 01.07.2005.

4.1.3. Për depozitën në Raiffeisen Bank, me vlerë 13.000.000 lekë, Komisionerja Publike ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni sa u përket burimeve të ligjshme të krijimit të saj, duke potencuar si vijon.

a. Të ardhurat e përfituara nga shoqëria “{***}” nuk mund të konsiderohen si burim i ligjshëm, pasi nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, sipas pretendimeve në paragrafët më lart.

b. Ngre dyshime mbi vërtetësinë e çmimit të shitjes së një toke bujqësore arë me sipërfaqe 1462 m², në datën 03.10.2007, në vlerën 10.000.000 lekë⁷. Këto dyshime bazohen në faktin që ky çmim shitjeje: (i) rezulton rreth 13 herë më i lartë nga çmimi i blerjes 760.000 lekë në vitin 2005; dhe (ii) çmimi i shitjes bie ndesh me kartelën e pasurisë së paluajtshme, datë 01.11.2007, të lëshuar në emër të blerësit, në të cilën kjo pasuri referohet me vlerë 10.000 lekë, shumë herë më e ulët se çmimi i deklaruar i shitjes së kësaj pasurie.

4.1.4. Në lidhje me analizën financiare ndër vite, Komisionerja Publike potencon në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e përlogaritura nga Komisioni si më poshtë përmbledhur.

a. Të ardhurat e pretenduara nga shitja e një gjeneratori në vitin 2011, nuk mund të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive dhe mbulimit të shpenzimeve për vitin 2011, për shkak se nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore dhe atë vetting, sikurse ka pranuar edhe vetë subjekti në përgjigjet e procesverbalit të ILDKPKI-së, datë 11.02.2015.

b. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar shpenzime shkollimi vetëm në deklaratën për vitin 2013, dhe jo në vitet në vijim, 2014, 2015 e 2016, në mosrespektim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, për deklarimin e shpenzimeve të deklarueshme me

⁷ Shumë e cila ka shërbyer si burim për krijimin e bonove të thesarit.

vlerë mbi 300.000 lekë. Për rrjedhojë, subjekti ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë, në lidhje me shpenzimet e shkollimit. Ankuesja pretendon se ka qenë e drejtë dhe në përputhje me aktet e administruara përlllogaritja e kryer nga Komisioni në analizën financiare të rezultateve të hetimit, lidhur me shpenzimet e shkollimit, ku janë përfshirë tarifatat vjetore të shkollimit dhe shpenzimet e jetesës sipas të dhënave të Eurostat-it.

c. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës të rezultatit të hetimit mbi burimet e ligjshme dhe pamjaftueshmërinë financiare në vlerën rreth 3.400.000 lekë të konstatuar për vitet 2011, 2014 dhe 2015.

4.1.5. Për pasurinë tokë bujqësore me sipërfaqe prej 1.750 m², Komisionerja Publike ngre dyshime mbi ligjshmërinë e të ardhurave nga shitja e kësaj pasurie në vlerën prej 210.000 eurosh, me kontratën e datës 04.01.2013⁸, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Sipas pretendimeve në ankim, çmimi 210.000 euro i përcaktuar në kontratën e shitjes, nuk gjen pasqyrim në kartelën e kësaj pasurie të lëshuar në emër të blerësve, në të cilën nuk referohet asnjë vlerë e shumës së paguar për këtë pasuri. Kjo problematikë pretendohet nga ankuesja se duhet analizuar nga Kolegji në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, së bashku me shkaqet e tjera në ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

4.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, Komisionerja Publike, pretendon si vijon.

4.2.1. Në konsideratë të indicieve të institucioneve të verifikimit dhe raportit të DSIK/AKSIK-ut, gjetjet në *procedimin penal nr. {***}/2019, në ngarkim të të pandehurit M. A.*, nuk duhen transferuar për inspektim pranë ILD-së, por duhen bërë pjesë e vlerësimit tërësor të çështjes në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ku, më së paku, duhen vlerësuar në drejtim të indikatorëve të aftësive profesionale të prokurorit, parashikuar në nenet 73, pika 3 dhe 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

4.2.2. Kolegji duhet të bëjë pjesë të vlerësimit tërësor edhe *procedimin penal nr. {***}, datë 18.06.2019*⁹, pasi provohet që subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrat e lëna nga Gjykata. Këto veprime afektojnë kriterin e aftësisë profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 3, nenin 74, pikat 2 dhe 4 dhe nenin 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

4.2.3. Problematikat e konstatuara më sipër, duhen trajtuar nga Kolegji eventualisht, së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si situata që mund të ndikojnë në cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

⁸ Të ardhurat nga shitja e kësaj toke [e fituar me trashëgim nga prindërit, të cilët e kishin përfitur në bazë të ligjit 7501 – sipas përshkrimit në numrin rendor 6, në deklaratën vetting], janë deklaruar si burim krijimi për pasurinë e llojit obligacione në Bankën e Shqipërisë, me afat 5-vjeçar, krijuar në datën 08.05.2014, në vlerën 15.000.000 lekë [pasuria me numrin rendor 8 në deklaratën vetting].

⁹ Të shqyrtuar nga Komisioni në kuadër të denoncimit të znj. S. P.

IV. Pretendime dhe akte të depozituara nga palët në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

5. Në Kolegj u depozituan parashtrime dhe akte nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme¹⁰ dhe nga subjekti i rivlerësimit¹¹. Aktet e depozituara në Kolegj, iu njoftuan respektivisht Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, subjektit të rivlerësimit dhe Vëzhguesit Ndërkombëtar.

5.1. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u shpreh se *u qëndron të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik*. Subjekti i rivlerësimit *nuk* arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë, e për rrjedhojë i kërkon Kolegjit të vendosë *ndryshimin e vendimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit*.

5.2. Subjekti i rivlerësimit shprehet se ankimi i Komisioneres Publike nuk shoqërohet me elementë të rinj provues, fakte të pa paraqitura më parë apo argumentim juridik që të cenojë ose përmbysë arsyetimin e Komisionit. Sipas tij, ankimi i Komisioneres Publike në thelb, përbën një lexim selektiv e fragmentar të hetimit administrativ, duke devijuar nga qëllimi kushtetues dhe *ratio legis* i procesit të rivlerësimit, garantimi i integritetit dhe i aftësisë për ushtrimin e funksionit, në drejtim të një logjike sanksionuese të pambështetur në standardin e provës. Për pasojë ankimi nuk përshtatet me frymën dhe objektivat e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk përmbush kërkesat kumulative të proporcionalitetit, të ligjshmërisë dhe të vlerësimit të plotë, të drejtë dhe të paanshëm të provave. Në mënyrë të përmbledhur subjekti ka parashtruar si vijon:

5.2.1. Sa i përket kontrollit të pasurisë, ka përmbushur standardin e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetues. Për këtë arsye, shkaqet ankimore në lidhje me këtë kriter, duhen rrëzuar. Prej vitit 2015 të emërimit në detyrë dhe në vijim, ka deklaruar rregullisht pasuritë e krijuara para fillimit të detyrës. Vlerësimi duhet të jetë garantist, në respektim të parimit të sigurisë juridike dhe të proporcionalitetit. Në parim, subjekti dakordëson me qëndrimin e Komisionerit Publik për domosdoshmërinë e verifikimit të pasurive të ankimuara, por nuk ndan të njëjtën qasje në barazimin kohor që u bëhet pasurive të vëna përpara detyrës, me ato të krijuara gjatë ushtrimit të funksionit publik. Pasuritë e ankimuara janë krijuar përpara marrjes së funksionit dhe për më tepër i përkasin familjes së tij të origjinës e janë përfituar prej tij me trashëgim, si i vetmi trashëgimtar. Trashëgimia, i jep pasurive një karakter të dallueshëm nga të ardhurat e lidhura me funksionin publik, e duhet marrë në konsideratë dhe vlerësuar nga Kolegji nën dritën e disa rrethanave si: (i) deklaratimet e vazhdueshme që nga viti 2015; (ii) aktet e trashëgimisë; (iii) pamundësinë objektive të rikuperimit të dokumentacionit financiar pas shumë vitesh dhe (iv) jurisprudencën e Kolegjit se pasaktësitë në deklaratime, të pashoqëruara me mungesë burimesh të ligjshme, nuk mund të përkthehen në përgjegjësi disiplinore të subjektit. Më në detaj, pretendimet konkrete për këtë kriter do të shtjellohen në vijim, gjatë analizës së pasurive sipas shkaqeve të ankimit.

¹⁰ Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, përmes shkresës nr. {***} prot., datë 29.10.2025, depozitoi në Kolegj parashtrimet kundër vendimit të Komisionit, si edhe autorizimin nr. {***} prot., datë 29.10.2025, për përfaqësimin e tij në këtë çështje, nga z. Adnan Xholi, me funksion prokuror pranë kësaj prokurorie.

¹¹ Në datën 30.10.2025, nëpërmjet e-mail-it dhe, fizikisht, në datën 31.10.2025, subjekti i rivlerësimit depozitoi parashtrësia dhe kërkesë për marrjen në cilësinë e provës të akteve bashkëlidhur parashtrimeve e konkretisht: (i) kopje e njëhësuar me origjinalin e shkresës nr. {***}, datë 07.02.2024, të e shoqërisë {***} ShPK dhe shkresës nr. {***} prot., datë 02.02.2024, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Durrës; (ii) ekstrakt i llogarisë bankare nr. {***} i Intesa Sanpaolo Bank (statement), printim, i nënshkruar dhe i vulosur nga banka; fotokopje të dokumenteve të shkollave “{***}” dhe “{***}”..

5.2.2. Në prapësim të shkaqeve ankimore në drejtim të kriterit të vlerësimit profesional dhe atij tërësor të çështjes, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime në lidhje me të dyja procedimet penale të ankimuara, duke pretenduar se hetimet e kryera prej tij kanë qenë të plota, në përputhje me ligjin material dhe procedural penal dhe se ai ka përmbushur në mënyrë ezauruese detyrat e lëna nga gjykata.

V. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

A/i. Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja me objekt shqyrtimi kundërshtimin e vendimit të Komisionit bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit, me përbërjen si në pjesën hyrëse të këtij vendimi, është rezultat i shortit të zhvilluar në datën 03.06.2024, i cili është publikuar në internet në faqen zyrtare të Kolegjit.

A/ii. Legjitimimi i ankuesit

7. Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

A/iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

8. Shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 738, datë 22.02.2024, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisionerja Publike, u zhvillua në seancë gjyqësore publike, në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

8.1 Në seancën gjyqësore të datës 05.11.2025, për shkak të mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë dhe bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe të nenit 199, paragrafi i 2-të i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues i Kolegjit vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Ky i fundit, në bazë të autorizimit të datës 29.10.2025, u përfaqësua nga prokurori Adnan Xholi. Në këtë seancë, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, gjatë paraqitjes së shkaqeve të ankimit deklaroi në linjë me ankimin e Komisioneres Publike, sikurse referuar më sipër. Konkretisht, në mënyrë të përmbledhur, ai u shpreh se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive të tij të luajtshme e të paluajtshme. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kërkoi që disa gjetje të evidentuara në vlerësimin e aftësive profesionale, së bashku me problematikat në kriterin e vlerësimit të pasurisë, të vlerësohen nga Kolegji edhe lidhur me kriterin e vlerësimit të figurës, nën frymën e nenit 4, pika 2

e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të nenit 61, pika 5 e po këtij ligji. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 738, datë 22.02.2024 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

8.2 Subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesja e tij ligjore kundërshtuan shkaqet e ankimit dhe dhanë shpjegime të detajuara për secilin prej tyre, duke deklaruar se nëpërmjet provave në dosje, vërtetohet burimi i ligjshëm i krijimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe ndërmarrja e veprimeve të duhura hetimore prej tij gjatë ushtrimit të detyrës. Subjekti i rivlerësimit kërkoi të pranohen në cilësinë e provës disa akte bashkëlidhur parashtrimeve të tij¹². Trupi gjykues vendosi të mos pranojë aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës, pasi konstatoi se ato janë pjesë e fashikullit të Komisionit, të përcjellë në Kolegj. Palët u bënë me dije se këto akte do të mbahen në konsideratë sikurse edhe të tjerat në analizën e prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, si evidentim të aspekteve me rëndësi sipas tij.

8.3 Në bisedimet përfundimtare, në seancën e datës 05.12.2025¹³, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Adnan Xholi¹⁴, u qëndroi shkaqeve të ankimit. Ai argumentoi se gjatë procesit të zhvilluar në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, duke u gjendur në kushtet e deklaramit të pasaktë e të pamjaftueshëm e me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive të tij. Po ashtu, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme u shpreh se veprimtaria hetimore e subjektit të rivlerësimit afekton kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të tij dhe kërkoi që problematikat në gjetjet e evidentuara në ankim, të vlerësohen nga Kolegji edhe lidhur me kriterin e vlerësimit të figurës, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të nenit 61, pika 5 e po këtij ligji. Përfundimisht, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 738, datë 22.02.2024 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

8.4 Subjekti i rivlerësimit, në bisedimet e tij përfundimtare¹⁵, deklaroi se, pas shpjegimeve të dhëna prej tij, bazuar në provat në dosje, gjatë procesit të zhvilluar në Kolegj, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nuk duhet t'u qëndronte shkaqeve të ankimit, pasi është arritur të përmbysset barra e provës. Përfundimisht, subjekti i rivlerësimit i kërkoi Kolegjit rrëzimin e ankimit të Komisionerit Publik, si të pabazuar në prova e ligj dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit.

B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

9. Pasi analizoi pretendimet e ngritura në ankim, parashtrimet e konkluzionet përfundimtare të palëve, si dhe nga shqyrtimi i provave të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se vendimi i Komisionit *nuk* është i bazuar e *duhet të ndryshohet*. Arsyetimi mbi të cilin u bazua ky konkluzion shtjellohet në vijim.

¹² Referuar më sipër, në poshtëshënimin nr. 11 të këtij vendimi.

¹³ Për arsye objektive, seanca gjyqësore e planifikuar për t'u zhvilluar në datën 26.11.2025, ora 10:00, u shty për në datën 05.12.2025, ora 10:00.

¹⁴ Përfaqësuesi i Prokurorisë së Posaçme lexoi në mënyrë të përmbledhur konkluzionet me shkrim që i depozitoi në këtë seancë.

¹⁵ Bisedimet përfundimtare me shkrim iu vunë në dispozicion trupit gjykues dhe palëve në këtë seancë.

I. Kriteri i vlerësimit të pasurisë

I./1 Të ardhurat e deklaruara nga marrëdhënia me shoqërinë “{***}”

10. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura totale në vlerën 155.800 USD, të realizuara gjatë periudhës nëntor 1998 - tetor 2003, nga dhënia me qira e shtëpisë në {***} Durrës, kompanisë “{***}”, si edhe nga punësimi i tij si ekonomist në të njëjtën shoqëri.

10.1 Komisioni i ka analizuar këto të ardhura në funksion të kontrollit të burimeve të ligjshme të disponuara nga subjekti për efekt të krijimit të një toke bujqësore me sipërfaqe 3.682 m², në fshatin {***} ({***}, Durrës) – e cila nuk është shkak ankmi në vetvete¹⁶. Përfundimisht, dhe për sa ka relevancë ky konkluzion në çështjen e shqyrtuar në Kolegj, Komisioni konkludoi se të ardhurat e pretenduara nga marrëdhënia e punësimit me shoqërinë “{***}” e po ashtu edhe nga marrëdhënia e qirasë me të njëjtën shoqëri, e kalojnë testin e ligjshmërisë.

10.2 Komisionerja Publike, në mënyrë të përmbledhur, pretendon se deklaratimet e subjektit për të ardhurat nga qiraja dhe punësimi nga shoqëria “{***}” janë kontradiktore dhe nuk përputhen me provat shkresore të depozituara nga vetë subjekti në ILDKPKI. Deklarimet kontradiktore qoftë për shumat respektive të fituara ashtu dhe për kohën e realizimit të këtyre të ardhurave, në mungesë të akteve dhe provave të kohës mbi mënyrën e arkëtimit të këtyre të ardhurave, e bëjnë të vështirë përlllogaritjen e tyre për të evidentuar mundësinë financiare reale të subjektit për krijimin e pasurive të deklaruara. Konkretisht:

- (i) Për të ardhurat nga qiraja, subjekti nuk arriti të provojë përfitimin e tyre në kohën dhe shumën e pretenduar, dhe as shlyerjen e detyrimeve tatimore. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë kontradiktore dhe nuk përputhen me provat e dorëzuara nga vetë ai, të cilat nuk provojnë realizimin dhe krijimin e të ardhurave nga qiraja para datës 20.03.2000; ndërmjet deklaratës *vetting* dhe deklaratës së parë të vitit 2005, ka mospërputhje¹⁷ qoftë për shumën e të ardhurave dhe për periudhën e realizimit të tyre.
- (ii) Për të ardhurat nga punësimi i subjektit në këtë shoqëri, duhet të konsiderohen deri në masën që provohet nga dokumentacioni i ISSh-së.

¹⁶ Objekt vlerësimi i Komisionit ka qenë kjo tokë bujqësore, e cila nuk është shkak ankimi, ndërsa të ardhurat nga “{***}” janë shqyrtuar nga Komisioni për shkak se kanë shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri dhe për pasuri të tjera.

¹⁷ Komisionerja publike evidenton në ankim mospërputhjet si vijon: (i) Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga qiraja e shtëpisë në {***}, Durrës, dhënë kompanisë “{***}” dhe nga punësimi i tij si ekonomist në këtë shoqëri (nëntor 1998 - tetor 2003), nëntor 1998 - mars 2003 nga 1.000 dollarë muaji, mars 2000 - 30 tetor 2003 nga 3.200 dollarë në muaj, në pagesën mujore në këtë periudhë ishte bashkë, qiraja e banesës dhe paga ime si ekonomist. (ii) Në deklaratën e parë të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Qira nga shtëpia, vitet 2000-2004, 3.000 dollarë në muaj. Qira vjetore 36.000 USD, paguar firma “{***}”. (iii) Në përgjigje të barrës së provës së Komisionit, subjekti ka prapësuar se të ardhurat që prindërit e tij kanë përfituar nga qiraja e shtëpisë, nga shoqëria “{***}”, për periudhën nëntor 1998 - tetor 2003, janë në shumën 156.800 dollarë amerikanë.

(iii) Edhe për të ardhurat e pretenduara nga *marrëdhënia e punësimit* të subjektit me këtë shoqëri, ankuesja pretendon se deklaratimet e subjektit janë kontradiktore¹⁸ dhe jo në përputhje me dokumentacionin e administruar.

(iv) Për aspektin *e ligjshmërisë* së këtyre të ardhurave, subjekti ka kryer deklaratime kontradiktore, pasi në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se titullare e detyrimit tatimor për qiranë e banesës ka qenë e ëma, e cila, në dijeninë e tij, duhet t'i ketë shlyer këto detyrime pasi ishte e kujdesshme karshi tyre. Ndërsa, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka pretenduar pamundësinë e tij objektive për sigurimin e dokumentacionit provues për pagimin e tatim fitimit dhe se, sipas legjislacionit tatimor të kohës, nëna e tij/qiradhënësi individ kishte detyrim vetëm për periudhën 15.01.1999 - 01.01.2002, ndërsa për periudhat e tjera, ka qenë detyrim i shoqërisë “{***}”/qiramarrësi ndërmarrje.

10.3 Në përfundim, Komisionerja Publike pretendon se të ardhurat nga marrëdhënia e qirasë, nuk duhen përfshirë në analizë financiare, në mesin e të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, për krijimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme, si dhe mbulimin e shpenzimeve ndër vite, ndërsa të ardhurat e pretenduara nga marrëdhënia e punësimit pranë së njëjtës shoqëri, duhet të konsiderohen deri në masën që provohet nga dokumentacioni i ISSh-së.

10.4 Në bisedimet e tij përfundimtare, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme mbajti qëndrim të njëjtë me atë të parashtruar në ankim, duke potencuar se edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti ndonjë argument, akt apo provë të re për të ardhurat nga qiraja dhe punësimi, objekt i këtij shkaku ankimor. Legjitimiteti i këtyre të ardhurave të deklaruara mbeti i paprovuar, parë edhe në kuadër të deklaratimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, mbi periudhën e qiradhënies, arsyen e përfitimit¹⁹ dhe shumën e përfituar nga kjo marrëdhënie. Të ardhurat e deklaruara nga qiradhënia me “{***}”, nuk u provuan se plotësojnë kushtet e ligjshmërisë, parashikuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nuk duhen përfshirë në mesin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme dhe mbulimin e shpenzimeve ndër vite, sipas deklaratimeve të subjektit. Sa u takon të ardhurave të pretenduara nga marrëdhënia e punësimit të subjektit pranë së njëjtës shoqëri, vlerësohet se duhet të konsiderohen si të ardhura të ligjshme deri në masën që provohet nga dokumentacioni i ISSh-së.

10.5 Subjekti i rivlerësimit ka prapësuar në tërësi konkluzionet e mësipërme, duke pretenduar se të ardhurat nga qiraja dhe punësimi pranë shoqërisë në fjalë, plotësojnë standardin kushtetues të të ardhurës së ligjshme e duhet të përfshihen të plota në analizën financiare. Këto të ardhura të përfituara shumë kohë përpara fillimit të ushtrimit të funksionit si prokuror dhe jashtë periudhës së rivlerësimit,

¹⁸ Komisionerja Publike evidenton në ankim mospërputhjet si vijon: (i) në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga punësimi i tij si ekonomist në shoqërinë “{***}” (nëntor 1998 - tetor 2003), nëntor 1998 -mars 2003 nga 1.000 USD (një mijë dollarë muaji); (ii) në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 5 shkurt 2015, ka deklaruar se nga puna part time në këtë shoqëri ka fituar 2.000 USD në muaj dhe se nuk disponon dokument punësimi nga kjo kompani; (iii) në prapësimet kundër rezultateve të hetimit, subjekti për herë të parë deklaroi se nga bisedat me ish-kolegë, u kujtua që ky person juridik kishte lidhur marrëveshje me “{***}” ShPK, për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve shqiptarë. Nga dokumentacioni i marrë prej subjektit nga shoqëria “{***}” ShPK dhe ISSh Durrës, rezulton se për periudhën 2001-2003, ai është deklaruar nga kjo shoqëri dhe siguruar pranë ISSh-së për shumat minimale rreth 9.000 lekë pagë bruto, të cilat janë ndjeshëm më të ulëta se vlerat e pretenduara dhe deklaruara nga subjekti.

¹⁹ Në formë shpërblimi, për qira ambienti dhe/apo si e ardhur nga punësimi i subjektit.

duhen vlerësuar nën dritën e parimeve të proporcionalitetit, meqenëse nuk u identifikua fiktivitet në shitblerjen e tokës bujqësore, të blerë në vitin 2002 në vlerën 480.000 lekë, apo të fiktivitetit të këtij burimi. Subjekti potencon edhe që në deklaratën *vetting*, ka deklaruar të ardhurat totale prej 156.800 USD, të përfituara gjatë periudhës nëntor 1998 - tetor 2003 nga qiradhënia e banesës shoqërisë dhe nga angazhimi i atij vetë me kohë të pjesshme si ekonomist pranë së njëjtës shoqëri. Ai ka provuar me prova shkresore, marrëdhënien e qirasë dhe të punësimit, gjurmën tatimore/fiskale dhe pamundësinë objektive për të siguruar dokumentacionin për shkak të kohës së largët. Ka depozituar dokumentacion që provon këto marrëdhënie e konkretisht: (i) kontratat e qirasë të lidhura ndërmjet nënës së tij dhe shoqërisë në fjalë për vitet 2000, 2001, 2002 dhe janar - tetor 2003 me vlerë 3200 USD/muaj [në të cilën përfshihej qiraja e banesës dhe paga si ekonomist]; (ii) listat e personelit të shoqërisë “{***}”; (iii) marrëveshja ndërmjet kësaj shoqërie dhe shoqërisë “{***}” ShPK për sigurimin e punonjësve; si dhe (iv) listëpagesat e siguruara nga ISSh-ja Durrës, të vlerësuara në harmoni me njëra-tjerën. Pretendimet e subjektit shtjellohen në vijim të këtij vendimi, gjatë trajtimit të pretendimeve të potencuara në ankim dhe parashtrime.

10.6 Pas kontrollit të ushtruar mbi vendimin objekt shqyrtimi për këtë shkak ankimi dhe nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, analizuar nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit mbërriti në një konkluzion të ndryshëm nga Komisioni. Konkretisht, për të ardhurat e deklaruara nga *marrëdhënia e punësimit* me shoqërinë “{***}”, trupi gjykues i Kolegjit, ndryshe nga Komisioni, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë përfitimin dhe ligjshmërinë e pagës mujore në vlerën e deklaruar, *vetëm* për periudhën e referuar në dokumentacionin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Durrës. Nga ana tjetër, *të ardhurat nga qiraja*, përfituar në saje të marrëdhënies me të njëjtin person juridik [“{***}”] u konstatuan në mospërbushje të kriterit të ligjshmërisë, përcaktuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës. Për pasojë, këto të ardhura nuk u përfshinë në mesin e burimeve të ligjshme të subjektit e familjes së tij, për efekt të krijimit të pasurive sipas deklaramit. Konkluzionet e mësipërme e shtrijnë efektin financiar mbi disa pasuri të krijuara nëpërmjet këtyre fondeve²⁰, pavarësisht se trajtimi dhe analiza e tyre është bërë nga Komisioni në funksion të kontrollit të tokës bujqësore. Arsyetimi mbi të cilin bazohen këto konkluzione, është rrjedhojë e situatës faktike ligjore që rezultoi në Kolegji nga shqyrtimi i akteve, shtjelluar në detaj në vijim.

10.7 Komisionerja Publike dhe përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kanë pretenduar se subjekti ka kryer deklarime kontradiktore për periudhën e qiradhënies, arsyen e përfitimit²¹ dhe shumën e përfituar, të cilat nuk përputhen me provat shkresore të depozituara nga vetë subjekti. Problematikat e konstatuara në deklarime kanë ndikuar në legjitimitetin e të ardhurave të deklaruara, i cili mbeti i paprovuar edhe parë në këtë kontekst. Sipas ankuesve, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë përfitimin e të ardhurave nga *qiradhënia e banesës* në kohën dhe

²⁰ Të ardhurat e pretenduara nga *marrëdhënia e qirasë dhe ajo e punësimit me shoqërinë “{***}”*, janë deklaruar/kanë shërbyer si burim krijimi për pasuritë: (a) tokë bujqësore me sipërfaqe 3682 m², nga e cila 300 m² truall dhe 56 m² ndërtesë, ndodhur në fshatin {***}, Durrës, blerë me anë të kontratës së shitblerjes, datë 14.11.2002, me vlerë 480.000 lekë; (b) tokë bujqësore me sipërfaqe 2717 m², ndodhur në fshatin {***}, Durrës, në vlerën 1.300.000 lekë, blerë me anë të kontratave të shitblerjes të datave 27.10.2003 dhe 03.03.2005; (c) apartament banimi me sipërfaqe 150,9 m², ndodhur në Tiranë [ndarë në dy apartamente, si dhe tri garazhe], me vlerë totale 142.000 euro; (ç) depozitë në Raiffeisen Bank, krijuar në vitin 2014, me vlerë 13.000.000 lekë; (d) pasuritë e tjera të krijuara nga pasuritë e mësipërme; (e) shpenzimet për arsimin e fëmijëve.

²¹ Në formë shpërblimi për qira ambienti dhe/apo si e ardhur nga punësimi i vetë subjektit.

shumën e pretenduar dhe as shlyerjen e detyrimeve tatimore, si standard kushtetues. Për rrjedhojë, këto të ardhura nuk duhen përfshirë në analizë financiare për krijimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme, si dhe mbulimin e shpenzimeve ndër vite.

10.8 Subjekti prapëson në tërësi konkluzionin e mësipërm duke potencuar se ka deklaruar saktë shumën e përfituar, kohën së cilës ajo i përkiste dhe llojin e marrëdhënies [qira e punësim me kohë të pjesshme]. Subjekti po ashtu pretendon se deklarimi periodik për vitin 2004 [kryer në datën 30.06.2005], është i përmbledhur në total vjetor, ndërsa deklarata *vetting* është e hollësishme, me ndarje sipas periudhave (1998-2003) dhe sipas zërave (qira/pagë), që sqaron përmbajtjen e deklarimit të mëhershëm.

10.9 Pretendimi i Komisioneres Publike është i bazuar në këtë aspekt, sikurse edhe në atë që lidhet me mungesë konsistence të subjektit në deklarimet e ndryshme për vlerat e fituara. Së pari, subjekti ka qenë inkonsistent në deklarimet e tij ndër vite, në deklaratën *vetting* dhe në procesin e hetimit administrativ për përfitimin që ka marrë nga “{***}” në nivel sasior dhe në natyrën e secilit raport. Konkretisht, në deklaratën *vetting*²², në ILDKPKI²³ dhe në pyetësorët²⁴ nr. 1 standard, nr. 2 dhe nr. 3, subjekti ka deklaruar se ka përfituar një pagesë mujore prej 3.000 ose 3.200 USD, ku përfshiheshin qiraja prej 1000 USD/muaj dhe paga prej 2000 USD/muaj si ekonomist pranë së njëjtës shoqëri. Nga ana tjetër, në deklaratat periodike për vitet 2004, 2009 dhe 2015, të ardhurat janë përshkruar si shpërblim për *qiranë* e banesës. Vlera e përfituar referohet në mënyrë jokonsistente: herë me vlerë 3.000 USD në muaj, apo 36.000 USD në vit gjatë periudhës 2000 - 2004 (deklarata për vitin 2004), dhe herë pa një vlerë konkrete, e shtrirë në periudhën 1998 - 2002 apo 1998 - 2003 (deklarata për vitin 2009), apo në vitet 1998 - 2002 (deklarata për vitin 2015).

10.10 Sa sipër, rezulton se subjekti ndër vite ka deklaruar vetëm marrëdhënie qiraje si shkakun për të cilin janë krijuar të ardhurat. Duke filluar nga kontrolli i ushtruar nga ILDKPKI-ja në shkurt 2015 e në vijim, subjekti ka specifikuar edhe që ka qenë edhe i punësuar me kohë të pjesshme. Këto mospërputhje u mbajtën në konsideratë nga trupi gjykues i Kolegjit në drejtim të besueshmërisë së shpjegimeve të subjektit, ndërsa analiza financiare e burimeve të ligjshme të disponuara nga subjekti përfshiu të ardhura për periudhat gjatë të cilave ka dokumentacion, por përtej vlerës minimale. Ky konkluzion është rrjedhojë e konstatimit që niveli i pagës së subjektit nga ky punësim, është i

²² Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura totale në vlerën 155.800 USD, të realizuara gjatë periudhës nëntor 1998 - tetor 2003, nga dhënia me qira e shtëpisë në {***}, Durrës, kompanisë “{***}”, si edhe nga punësimi i tij si ekonomist në të njëjtën shoqëri. Deklarata vijon me përshkrimin e periudhave të realizimit të këtyre të ardhurave: (i) gjatë periudhës nëntor 1998 – mars 2000, ka përfituar shumën 1000 USD në muaj; (ii) në periudhën mars 2000 – 30 tetor 2003, ka përfituar 3200 USD në muaj. Në këtë pagesë ishin të përfshira pagesa e qirasë dhe paga e tij si ekonomist pranë së njëjtës shoqëri; (iii) në tetor 2003, kjo shoqëri mbaroi misionin në Shqipëri. Për periudhën nëntor 1998 – mars 2000, subjekti ka deklaruar se nuk disponon dokument.

²³ Referuar procesverbaleve, datë 5 shkurt 2015 dhe 11 shkurt 2015, subjekti ka deklaruar në ILDKPKI se nga puna e tij me kohë të pjesshme pranë shoqërisë “{***}”, ka fituar rreth 2.000 USD në muaj. Subjekti ka deklaruar po aty se përveç pagës, ka përfituar nga kjo shoqëri edhe një shumë afërsisht 1000 USD/muaj, nga dhënia me qira e dy kateve të banesës për afro 3 vjet. Pagesa totale mujore ishte afërsisht 3000 USD/muaj dhe, në të, përfshihej qiraja prej 1000 USD/muaj dhe paga prej 2000 USD/muaj.

²⁴ Në pyetësorin standard, pyetësorin nr. 2 dhe pyetësorin nr. 3, subjekti është shprehur se prindërit e tij i kishin dhënë me qira shoqërisë “{***}”, shtëpinë e banimit për periudhën nëntor 1998 – tetor 2003. Fillimisht, më 1 nëntor 1998 deri në mars 2000, është dhënë me qira vetëm papafingoja [kati i dytë] e banesës me një vlerë 1.000 USD/muaj. Më pas, kompania mori me qira edhe një pjesë tjetër të banesës, kundrejt qirasë 3.200 USD/muaj. Në këtë pagesë do të përfshihej edhe paga e subjektit si ekonomist pranë kësaj kompanie. Të ardhurat nga “{***}” për periudhën mars 2000 – tetor 2003, kanë qenë 3200 USD/muaj, në total për të gjithë periudhën 155.800 USD.

identifikueshëm në aktet e kohës dhe, për shkak të një sërë rrethanash, të referuara edhe më sipër për mënyrën se si ka operuar punëdhënësi për deklarinimin e punonjësve dhe të ardhurave respektive pranë institucioneve përgjegjëse tatimore, ngarkimi me përgjegjësi individuale të subjektit do të ishte qasje joobjektive.

10.11 Në deklaratën e parë të parë të pasurisë, dorëzuar në datën 30 qershor 2005 [për vitin 2004 – si oficer i policisë gjyqësore], subjekti ka deklaruar të ardhura nga “{***}” dhe një depozitë në Bankën Amerikane, në vlerën 3.000.000 lekë, pa deklaruar burimin e krijimit. Nga aktet bankare, rezulton se në periudhën 2000-2005, subjekti ka disponuar në Bankën Intesa Sanpaolo (ish-Banka Amerikane dhe Banka Italo-Shqiptare), vlera të konsiderueshme monetare, të cilat i ka depozituar në sistemin bankar, duke filluar nga viti 2001. Ndonëse këto veprime *nuk* konfirmojnë punësimin e subjektit, ato gjithsesi përbëjnë provë nëpërmjet së cilës konfirmohet disponimi i një sasive të konsiderueshme të ardhurash, sikurse deklaruar në deklaratat periodike/të interesave, në një periudhë kohore që edhe në kohë përkon me marrëdhënien e punësimit në fjalë. Po ashtu, edhe vlera që rezulton është e përafërt me ato të referuara nga subjekti në deklaratat e atyre viteve. Konkretisht, nga një përlllogaritje e thjeshtë, për periudhën mars 2000 - maj 2001, sipas deklarimeve të tij, subjekti dhe familjarët e tij kanë përfituar nga personi juridik në fjalë shumën prej 45.867 USD²⁵. Shuma 40.279 USD, e depozituar në bankë në qershor 2001, është e përafërt me atë të deklaruar. Këto rrethana kontribuojnë në kah të besueshmërisë së deklarimeve të subjektit se shumatat e referuara në deklaratën për vitin 2004 dhe në ato në vijim, janë derivat i të ardhurave nga marrëdhënia me shoqërinë e huaj në fjalë.

10.12 Nga shkresa e “{***}” ShPK që konfirmon shlyerjen e kontributit të sigurimit shoqëror për punonjësit e shoqërisë “{***}”, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur mes këtyre dy shoqërive, dhe kontrata e konsulencës së stafit të specifikuar në të, përcakton se shumata që do t’i paguhej shoqërisë “{***}” ShPK për shërbimin e konsulencës, do të mbetej fikse deri në datën 31 dhjetor 2001. Duke abstraguar nga fakti që kjo kontratë është pa datë përpilimi, lexuar në harmoni me listëpagesat e përcjella nga ISSh Durrës²⁶, mund të deduktohet se ky shërbim konsulencë duhet të ketë filluar në janar të vitit 2001. Këto rrethana, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, e bëjnë bindës pretendimin e subjektit për punësimin pranë këtij personi juridik.

10.13 Nga ana tjetër, aktet e sipërreferuara konfirmojnë punësimin *vetëm* për periudhën tetor 2001 - nëntor 2001 dhe janar 2002 - dhjetor 2003. Konkretisht, nga këto akte rezulton se të gjithë punonjësit e siguruar të referuar në to, deklarohen me pagë bruto nën kufirin ligjor prej 10.000 lekësh, e më pas 14.000 lekësh²⁷, prag mbi të cilin, sipas legjislacionit tatimor në fuqi²⁸, për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi, lindte detyrimi për pagimin e tatimit përkatës. Ky fakt përbën indicie se të ardhurat reale nuk janë pasqyruar të plota në dokumentacionin e deklaruar pranë organeve tatimore pasi është e pamundur që të gjithë punonjësit e “{***}” të kenë pasur të njëjtin nivel page, pavarësisht

²⁵ 29.867 USD për vitin 2000 dhe 16.000 USD deri në maj 2001. Në total 45.867 USD.

²⁶ Me propësimet kundër rezultateve të hetimit, subjekti depozitoi shkresën nr. {***} prot., datë 02.02.2024, të ISSh Durrës, nëpërmjet së cilës iu vunë në dispozicion listëpagesat e shoqërisë “{***}” ShPK, për periudhën janar 2001 – dhjetor 2003, ku evidentohet edhe emri i subjektit të rivlerësimit.

²⁷ Ndryshuar pragu përjashtues për TAP nga 10.000 lekë në 14.000 lekë me ligjin nr. 8841, datë 11.12.2001, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, ndryshuar me ligjin nr. 8711, datë 15.12.2000”.

²⁸ Referuar dispozitave në fuqi për kohën, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

funksioneve që ata kryenin. Për këto shkaqe, trupi gjykues vëren se pagesat minimale të kontributeve pranë ISSh-së pasqyrojnë bazën kontributive të raportuar sipas skemës administrative të kohës dhe jo nivelin real të të ardhurave. Në konsideratë të deklarimeve të subjektit për përfitime konsiderueshëm më të larta se paga minimale, e duke u dhënë vlerë provuese deklarimeve periodike sipas nenit 32, pika 5 e ligjit, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi si më të logjikshëm që deklarimi nga nënkontraktori për pragun minimal të pagës, përbën një veprim të njëanshëm të personit juridik, për të përmbushur detyrimet bazike të ligjit të kohës. Në këto rrethana, marrëveshja ndërmjet dy shoqërive duket të ketë shërbyer kryesisht për formalizimin e deklaramit të punonjësve të shoqërisë, për efekt të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pa reflektuar domosdoshmërisht nivelin real të shpërblimit të përfituar prej tyre.

10.14 Ky veprim i shoqërisë, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit do të ishte objektivisht i padrejtë të passillte efekt negativ mbi subjektin. Nga ana tjetër, në balancë të të gjitha rrethanave faktike që konkurrojnë, u vlerësua e pamundur të konfirmohet dijenia e subjektit për mënyrën sesi është vepruar nga punëdhënësi, në kushtet që paga nuk duket të jetë shlyer nëpërmjet veprimeve bankare²⁹, kurse nga ana tjetër, edhe subjekti ka depozituar sasi të përafërta likuiditetesh, në monedhën e pagesës së shërbimit [dollarë amerikanë], në sistemin bankar, në momente kohore që përkojnë përgjithësisht me kohën kur ka përfunduar marrëdhënia juridike në fjalë.

10.15 Bazuar në rrethanat e analizuara më lart, trupi gjykues i Kolegjit përfshiu në analizën e burimeve të ligjshme të disponuara nga subjekti i rivlerësimit vetëm vlerën *6.395.900 lekë [ekuivalenti i shumës 52.000 USD]*, që përbën vlerën e të ardhurave nga punësimi që rezulton e provuar si pasojë e një interpretimi integral e harmonik të akteve dokumentare të kohës, sikurse deklaramet e tij periodike dhe aktet shpresore të dërguara Komisionit nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që provojnë marrëdhënien e punësimit të subjektit.

10.16 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* që të ardhurat mujore prej 3.200 USD në muaj kanë qenë shumatore e dy aspekteve të marrëdhënies, nga e cila paga mujore prej 2.000 USD, ishte për punësimin. Për qiranë, subjekti ka deklaruar edhe që *nuk* disponon dokumentacion për periudhën *nëntor 1998 - mars 2000*. Subjekti ka potencuar se likuiditetet e paguara/të ardhurat nga shoqëria “{***}” janë mbajtur *cash* nga nëna e tij. Këto fonde, subjekti shprehet se i ka deklaruar në bankë në vijim, pasi u bë subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003. Subjekti ka depozituar edhe katër (4) kontrata qiraje të lidhura ndërmjet nënës së subjektit dhe shoqërisë “{***}”, që mbulojnë nëntë muaj të vitit 2000 [duke filluar nga marsi], gjithë vitin 2001 dhe 2002 dhe tre muaj të vitit 2003. Në këto kontrata, referohet kundërshtëpërblimi prej 3.200 USD në muaj, në të cilin përfshihej pagesa e qirasë dhe pagesa e punësimit si ekonomist i subjektit, por pa specifikuar vlerën konkrete për secilin zë.

10.17 Në procesverbalet e ILDKPKI-së, subjekti ka pretenduar se për rreth 3 vjet, qiraja ka qenë 1.000 USD në muaj. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se qiraja ishte 1.000 USD në muaj prej datës 1 nëntor 1998 deri në muajin mars 2000, për një pjesë të banesës. Pasi qiraja u shtri edhe për një pjesë tjetër të shtëpisë, dhe subjektit iu ofrua edhe punësimi si ekonomist me kohë të pjesshme, shoqëria ra dakord t’i paguante një vlerë mujore prej 3.200 USD, ku përfshihej dhe paga

²⁹ Detyrimi i punëdhënësve për dhënie e pagës vetëm nëpërmjet sistemit bankar, si edhe për vënien në dispozicion punëmarrësit, të informacionit për të gjitha elementet e pagës, shtesat e përfituara dhe ndalimet e mbajtura, sipas legjislacionit në fuqi, ka lindur me miratimin e ligjit nr. 136/2015²⁹.

e subjektit si ekonomist në këtë shoqëri. Sipas këtij shpjegimi, vlera e pretenduar nga qiraja ka qenë 1.200 USD/muaj, ndërsa nga paga 2.000 USD/muaj.

10.18 Në kundërshtim të pretendimit në ankim, subjekti i rivlerësimit ka potencuar se pretendimet për qiranë janë të pabazuara. Deklarimi i tij për vitin 2005, përbën një përmbledhje vjetore në total, ndërsa deklarata *vetting* është e hollësishme, me ndarje sipas periudhave (1998-2003) dhe sipas zërave (qira/pagë), duke sqaruar e jo mohuar përmbajtjen e deklarimit të mëhershëm. Subjekti ka provuar me dokumentacion të kohës, ekzistencën reale të kësaj marrëdhënieje qiraje. Nuk ka qenë ai titullar i saj, por e ëma. Për rrjedhojë, përgjegjësia për detyrimet tatimore nga kjo marrëdhënie nuk është e tij. Pamundësia objektive për të siguruar dokumentacionin që provon likuidimin e tatimit mbi qiranë kur subjekt tatimor ishte e ëma, nuk duhet ta ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit. Referuar jurisprudentës³⁰ së Kolegjit, mungesa e një pagese tatimore nuk legjitimon detyrimisht një konkluzion negativ ndaj subjekteve të rivlerësimit, përvese kur provohet se mospagimi i tatimeve ka ndodhur për faj të subjektit. Subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për moslikuidimin e tatimit nga ana e shoqërisë gjatë kohës kur subjekt tatimor ishte kjo e fundit. Kolegji³¹ ka vlerësuar se personat juridikë në një marrëdhënie qiraje veprojnë si agjentë tatimorë dhe mbartin detyrimin ligjor për mbajtjen në burim dhe derdhjen e tatimit. Mospasja e mandateve të pagesës të tatimit nuk mund të penalizojnë subjektin nëse provohet bindshëm, ekzistenca e së ardhurës. Deklarimi i tyre rregullisht dhe nëse mungojnë treguesit e keqbesimit apo të bashkëveprimit të subjektit në mospagimin e tatimit nga personi juridik.

10.19 Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të drejtë pretendimin e ankuesve për të mos përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara të ardhura nga *qiraja* përcaktuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, ndryshe nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit nuk përfshiu një shumë ekuivalente të këtij zëri në mesin e burimeve të ligjshme që dispononte subjekti për efekt të krijimit të pasurive në vijim. Ky konkluzion bazohet në arsyetimin në vijim.

10.20 Edhe duke abstraguuar nga pasaktësitë në deklarime e duke pranuar si vlerë mujore shumë 1.000 USD apo 1.200 USD, të pretenduar nga subjekti apo edhe si deduksion nga leximi sistematik i kontratave dhe deklarimet e shpjegimet e subjektit, trupi gjykues vëren se për periudhën nëntor 1998 – mars 2000, nuk ka dokumentacion provues për ekzistencën e qirasë, që përjashton edhe debatin për ligjshmërinë e të ardhurave, në kuptim të dispozitave kushtetuese e ligjore në rivlerësim. Pjesa e kohës që mbetet, paraqet probleme të ligjshmërisë dhe jo të planit ekzistencial, në kushtet që subjekti ka paraqitur kontrata dhe ka deklaruar ndër vite për këtë pjesë të marrëdhënies juridike me personin juridik në fjalë.

10.21 Nën dritën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ligjshmëria e të ardhurave të deklaruara kushtëzohet nga shlyerja e detyrimeve tatimore për to³². Konkretisht dhe sikundër pranohet edhe nga

³⁰ Subjekti ka referuar si jurisprudentë, vendimin nr. 20, datë 14.07.2021, për subjektin e rivlerësimit, znj. V. D.

³¹ Vendimet nr. 14, datë 15.06.2021 (subjekti i rivlerësimit I. B.); nr. 15, datë 15.06.2021 (subjekti i rivlerësimit K. S.); nr. 6, datë 17.03.2022 (subjekti i rivlerësimit H. K.)

³² Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës: “[3.] Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj [...]”.

vetë subjekti³³, detyrimi për likuidimin e të ardhurave nga qiraja ka rënë mbi nënën e subjektit, për periudhën 20.03.2000 - 31.12.2001³⁴, ndërsa për periudhën në vijim, janar 2002 - tetor 2003, ka qenë detyrim i shoqërisë “{***}”. Mbi bazën e kërkesës për informacion të subjektit, administrata tatimore³⁵ ka *konfirmuar* se nëna e tij *nuk* ka paguar tatim mbi qiranë për vitet 1998 – 2003, ndërsa qiramarrësi [shoqëria “{***}”] *nuk* figuron i regjistruar si tatimpagues. I njëjti institucion³⁶, në përgjigje të kërkesës së subjektit për të përcaktuar kujt i takonte detyrimi ligjor për të paguar tatimin, është kufizuar në citimin e *pjeshëm* të një dispozite që nuk gjen zbatim në rrethanat faktike e ligjore konkrete. Konkretisht, shkresa ka cituar pikën 1.4.1 të udhëzimit nr. 5/2006³⁷, e cila referon si përfitues të qiramarrjes persona jorezidentë apo rezidentë që nuk kanë regjistrim në organet tatimore shqiptare³⁸, ndërkohë që ka lënë jashtë e anashkaluar pjesën tjetër të parashikimit për mënyrën sesi veprohet për persona juridikë të huaj, të peregjistruar në Shqipëri, e cila qartazi ia ngarkon përgjegjësinë qiradhënësit rezident tatimor shqiptar³⁹.

10.22 Sa më sipër, trupi gjykues vëren se në kushtet që qiramarrësi ishte person juridik i huaj, i peregjistruar në Shqipëri e me objektiv qëndrimi të përkohshëm, fakte të njohura e deklaruara edhe nga subjekti i rivlerësimit nga njëra anë, dhe që subjekti e familja e tij, në cilësinë e qiradhënësve, ishin përfituesit e të ardhurave, nën dritën e normativës tatimore, shlyerja e detyrimeve u përkiste këtyre të fundit – qiradhënësve rezidentë shqiptarë. Fakti që personi juridik qiramarrës ishte me statusin *jorezident* në kuptim të legjislacionit tatimor shqiptar, ishte edhe arsyeja për të cilën detyrimet për sigurimet shoqërore të punëmarrësve, sikurse provuar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, janë shlyer nga punëdhënësi/qiramarrës vetëm nëpërmjet nënkontraktimit me një person juridik shqiptar. Së fundmi, ndonëse pa efekt në zgjidhjen e çështjes, trupi gjykues çmon të theksojë se është e pakuptimtë përse administrata tatimore, për arsye të pashpjeguara, në një ndër shkresat⁴⁰ në përgjigje të kërkesës së subjektit për interpretim gjatë hetimit administrativ, ka zgjedhur të citojë në mënyrë të cunguar aktin nënligjor, pikën 1.4.1 të udhëzimit nr. 5/2006, duke lënë jashtë pikërisht fjalinë e fundit, sipas së cilës barra e pagesës së detyrimeve tatimore në burim, qëndron mbi *përfituesin e të ardhurave*, pikërisht në rrethanat që gjejnë zbatim në rastin e subjektit, e konkretisht, kur qiramarrësit nuk janë rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë.

³³ Në pikën nr. 24 të parashkrimeve, subjekti ka pretenduar se gjatë periudhës 15.01.1999 deri rreth 10.01.2002, barra e likuidimit të tatimit mbi qiranë i përkiste individit, ndërsa për periudhën 10.01.2002 e në vijim, ky detyrim rëndonte mbi qiramarrësit.

³⁴ Referuar vetëm periudhave të provuara me kontratë, pasi për periudhën nëntor 1998 – mars 2000, nuk mund të argumentohet mbi ligjshmërinë, për sa kohë nuk ka dokumentacion provues për ekzistencën e kësaj marrëdhënieje qiraje.

³⁵ Me shkresën e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës, nr. {***} prot., datë 16.11.2023, depozituar me përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

³⁶ Përmes shkresës nr. {***} prot., datë 21.11.2023, sjellë nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

³⁷ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe pikën 1.4 të udhëzimit nr. 5, datë 30.04.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

³⁸ Dispozita e cituar në përgjigje, tekstualisht thotë: “Kur këto të ardhura realizohen nga persona jorezidentë, apo nga individë apo persona rezidentë shqiptarë që, në bazë të legjislacionit tatimor ekzistues, nuk janë të detyruar të regjistrohen në organet tatimore shqiptare, detyrimi tatimor do të mbahet në burim nga paguesi i të ardhurave”.

³⁹ Udhëzimi nr. 5/2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, pika 1.4.1, sipas të cilit, si përjashtim nga rregulli, në pamundësi të pagimit në burim pasi paguesi nuk ishte i detyruar të regjistrohej në Shqipëri, në fjalinë e fundit përcaktohet që “përfituesi i të ardhurave duhet të deklarojë dhe paguajë detyrimin tatimor në organin tatimor përkatës”.

⁴⁰ Shkresa nr. {***}, datë 21.11.2023, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës. Fjalja e fundit e sipërcituar në poshtëshënimin e mësipërm, është ometuar nga përgjigjja, duke pasqyruar detyrimin e pagimit të tatimit në burim vetëm për paguesit.

10.23 Pretendimi për *mospasje* dijëni nga subjekti për dinamikën e shlyerjes së detyrimit tatimor, duke ia atribuar barrën e kësaj marrëdhënieje tërësisht nënës së tij, u vlerësua si përpjekje për të përmirësuar situatën në rivlerësim. Në këtë linjë, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar vlerësimin e Komisionit se subjekti *nuk* mund ta shëronte problematikën apo se *nuk* kishte mundësi të derdhte tatimet meqenëse nëna kishte ndërruar jetë në vitin 2013. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë që subjekti: (i) ka qenë evaziv për sasinë ekzakte të të ardhurave nga qiraja në raport me ato nga punësimi apo që ky i fundit u deklarua për herë të parë vetëm në vitin 2015; (ii) ka qenë përfitues i drejtpërdrejtë i këtyre të ardhurave për shkak të bashkëjetesës me nënën; (iii) ka formim arsimor dhe karrierë profesionale, veçanërisht pasi subjekti u punësua në ILDKPKI në vitin 2009, që fokusohet në kontrollin e pasurive dhe, për pasojë, në dijëni të rëndësishme që ka shlyerja e detyrimeve tatimore në funksion të të provuarit të të ardhurave apo në pikën fundore, pasi u miratua kuadri ligjor i rivlerësimit në vitin 2016. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin që pretendimi i subjektit për *mospasje* dijëni mbi mosshlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruara nga qiraja, përbën përpjekje të kryer në funksion të procesit të rivlerësimit dhe jo pasqyrim të mënyrës se si është zhvilluar kjo marrëdhënie në realitet.

10.24 Në konkluzion të sa më sipër, ndryshe nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë përfitimin dhe ligjshmërinë e *pagës mujore* në vlerën e deklaruar *vetëm* për periudhën e referuar në dokumentacionin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Durrës. Ndërsa, për të ardhurat nga marrëdhënia e qirasë me të njëjtën shoqëri të huaj, ndonëse u evidentuan gjurmë në akte të kohës që provonin ekzistencën e tyre, subjekti dështoi të provojë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave për shkak se nuk arriti të provojë me dokumentacion: (i) likuidimin e detyrimeve tatimore për to; (ii) përjashtimin e nënës së tij nga detyrimi tatimor; (iii) pamundësinë objektive për të siguruar dokumentacion provues; (iv) dhe as që ndodhej në rrethanat e mirëbesimit. Në këto kushte, në analizën financiare të korigjuar në Kolegji, u përfshinë vetëm të ardhurat e përfituara nga punësimi i subjektit të rivlerësimit pranë shoqërisë “{***}” për periudhën e referuar në dokumentacionin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Durrës dhe jo të ardhurat e pretenduara nga qiradhënia e banesës së të njëjtës shoqëri.

I./2 Vlerësimi për apartamentin e banimit dhe garazhet në Tiranë

- 11.** Nga leximi i deklaratës së pasurisë *vetting*, rezulton se subjekti ka deklaruar pronësinë individuale mbi apartamentin e banimit të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, me sipërfaqe 150,9 m², të ndarë në dy apartamente dhe në tri garazhe, njëri prej të cilëve me sipërfaqe secili 20 m² dhe dy të tjerët 21 m². Po aty, subjekti ka deklaruar vlerën e pasurisë prej 142.000 eurosh dhe burimet që shërbyen për krijimin e kësaj pasurie, e konkretisht: (i) një kredi bankare prej 40.000 eurosh; (ii) 95.000 euro të përfituara në total nga shitja e një sipërfaqeje toke 2.173 m² bashkë me fushën e minifutbollit në këtë tokë, e konkretisht 3 milionë lekë/shitja e tokës dhe diferenca e përfituar nga shitja e investimit prej 47.000 eurosh të kryer për ndërtimin e fushës së minifutbollit; dhe (iii) 7.000 euro nga shitja e një tjetër pasurie tokë [me sipërfaqeje 1750 m² e çmim shitjeje 210.000 euro].

11.1. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të justifikuar pagesën në datën 19.01.2009, për likuidimin e shumës 144.054 euro nga çmimi total i pasurisë dhe për mbulimin e shpenzimeve të deklaruara dhe/apo të evidentuara deri në këtë datë. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike mbi këto

pasuri, të pashoqëruara me mungesë të burimeve financiare, nuk janë vlerësuar me peshë në vlerësimin tërësor të subjektit për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar. Komisioni: (i) nuk ka evidentuar problematika në lidhje me kredinë e marrë në Bankën Emporiki; (ii) ka arsyetuar se ndonëse subjekti i rivlerësimit *nuk* arriti të provojë me dokumentacion përfitimin e shumës 95.000 euro nga shitja e truallit dhe e pajisjeve të fushës së minifutbollit dhe as pagesën e detyrimeve tatimore në një qasje proporcionale, për efekt të analizës financiare, për sa kohë ka reflektuar si shpenzim shumën 47.000 euro të deklaruar si të investuar nga subjekti, kjo shumë duhet të reflektohet edhe si e ardhur e përfituar pas shitjes së investimit në këtë pasuri. Përfitimi në këtë rast nuk do t'i nënshtrohej pagesës së tatimit, pasi nuk pranohen të ardhura shtesë nga ky transaksion; (iii) për shumën 7.000 euro nga shitja e tokës bujqësore [me sipërfaqe 1.750 m² në vlerën 210.000 euro], Komisioni ka reflektuar këto shuma në analizën financiare të integruar në vendim⁴¹. Në këtë analizë financiare, Komisioni *pa bërë asnjë arsyetim*, ka përfshirë zërin “të ardhura të mundshme të kursyera nga familja Çopa, deri në datën 30.06.2005” me vlerë 8.590.717 lekë. Ky zë është shfaqur për herë të parë në vendim, duke mos qenë pjesë e analizës financiare paraprake të rezultateve të hetimit.

11.2. Komisionerja Publike pretendon se subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, për pamjaftueshmëri financiare në vlerën rreth (-) 8,9 milionë lekë, të konstatuar fillimisht nga Komisioni. Sipas Komisioneres Publike, rezultati financiar paraprak ndryshoi ndjeshëm pas përfshirjes së disa të ardhurave që nuk duheshin konsideruar si të ligjshme. Konkretisht, Komisionerja Publike potencon që: (i) Kolegji të përfshijë në mesin e të ardhurave të ligjshme vetëm shumën 3.000.000 lekë të referuar në kontratën e shitjes dhe në kartelën e pasurisë të një toke me një fushë minifutbolli në të dhe jo të gjithë shumën 95.000 euro, e cila nuk gjën mbështetje në aktet në dosjen e Komisionit, duke mos plotësuar për rrjedhojë kërkesat e ligjshmërisë së të ardhurave, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës; (ii) analiza financiare e Komisionit nuk pasqyron situatën faktike të rezultuar nga aktet, pasi në të është përfshirë një zë në vlerën 8.590.717 lekë, me emërtimin “të ardhura të mundshme të kursyera nga Familja Copa, deri në datën 30.06.2005”, e cila nuk shpjegohet se nga origjinon e, për më tepër, nuk rezulton e deklaruar në deklaratat periodike vjetore dhe as e pretenduar nga subjekti; (iii) përfshirja në mesin e burimeve të ligjshme e të ardhurave të mësipërme, ka ndryshuar ndjeshëm rezultatin financiar të analizës se kryer, duke çuar në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit mbulon me burime të ligjshme, krijimin e pasurive të mësipërme.

11.3. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare, konfirmoi qëndrimin në ankim dhe në parashtrimet e datës 29.10.2025. Në vlerësimin e tij, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi pamjaftueshmërinë e burimeve financiare, të konstatuar fillimisht nga Komisioni dhe burimet e ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për krijimin e pasurive. Në mënyrë konkrete, ai u shpreh se:

(i) Subjekti nuk ka provuar përfitimin e shumës 95.000 euro nga shitja e truallit dhe e pajisjeve të fushës së minifutbollit dhe as pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat shtesë. Arsyetimi i Komisionit mbi përfshirjen si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, edhe të vlerës së investimit prej 47.000 eurosh, nga shitja e pasurisë tokë arë dhe fushë minifutbolli, nuk mbështetet në kontratën e shitjes datë 05.11.2005 dhe në kartelën e pasurisë së

⁴¹ Tabela nr. 3, në faqen nr. 45.

paluajtshme, të cilat referojnë si çmim shitjeje vetëm vlerën 3.000.000 lekë. Deklarata noteriale e datës 23.01.2017, e hartuar rreth 11 vite më vonë se kontrata e shitblerjes e vitit 2005, e cila referon përfitimin edhe të një shume tjetër prej 70.000 eurosh, ndjeshëm më të lartë se shuma e përcaktuar në kontratën e shitjes së vitit 2005, nuk gjen reflektim në asnjë dokumentacion/akt tjetër. Në analizën financiare të periudhës, duhet të konsiderohet si e ardhur e ligjshme, vetëm shuma prej 3.000.000 lekësh, e përcaktuar në kontratën e shitblerjes midis palëve dhe reflektuar edhe në regjistrimin e kontratës pranë ZVRPP-së.

(ii) Shuma 8.590.717 lekë, e reflektuar në analizën financiare të vendimit si “*të ardhura të mundshme të kursyera nga familja Çopa deri në datën 30.06.2005*”, nuk është deklaruar në formë kursimi nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën për herë të parë të pasurisë së datës 30.06.2005.

(iii) Për të ardhurat e pretenduara nga shoqëria “{***}”, mbeti e paprovuar ligjshmëria e tyre për krijimin e kursimeve ndër vite. Referuar jurisprudencës së Kolegjit mbi kursimet në *cash*, kjo shumë nuk duhet të përfshihet në mesin e burimeve të ligjshme në analizën financiare të periudhës së analizuar.

11.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në analizën financiare të kësaj pasurie, duhet përfshirë e gjithë shuma 95.000 euro, dhe jo vetëm vlera 3.000.000 lekë e referuar në kartelën e pasurisë së paluajtshme. Kërkesa e Komisionerit Publik për ta kufizuar të ardhurën nga shitja nuk gjen mbështetje në prova që, sipas tij, provojnë: (i) *vijueshmërinë faktike dhe dokumentare* ndërmjet lejes së ndërtimit (gusht 2004), nisjes faktike të investimit (qershor 2006), kontratës noteriale (nëntor 2005) dhe përmbylljes së pagesave (brenda vitit 2006); (ii) *strukturën e dyfishtë të marrëdhënies së shitblerjes* (pasuri e paluajtshme dhe pajisje). Marrëdhënia kontraktore për këtë pasuri, ka prodhuar një kundërshtëpërblim në total prej 95.000 eurosh, i përbërë nga çmimi i truallit dhe vlera e pajisjeve dhe investimeve të minifushës së futbollit [i trajtuar me dokumentacion të veçantë komercial]; (iii) *derdhjen e tatimit* vetëm mbi vlerën 3 milionë lekë dhe jo mbi të gjithë shumën 95.000 euro, kryer për shkak të mospasjes dijeni në atë kohë që nuk ka qenë subjekt deklarues. Nëse do të kishte pasur si qëllim shmangien nga tatimi mbi të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie, kjo qasje do të ishte reflektuar edhe në transaksione më të hershme familjare, sikurse shitja e tokës së nënës në vitin 1995. Subjekti ka respektuar në vijimësi rregullat në fuqi.

11.5. Subjekti i rivlerësimit *nuk* ka parashtruar pretendime konkrete në lidhje me konstatimin për zërin “*Kursimet e tjera të mundshme*”, në vlerën afërsisht 8,5 milionë lekë, pa dhënë sqarime apo pretendime konkrete mbi sa pretenduar nga ankuesit. Ai ka kundërshtuar vetëm argumentin e Komisionerit Publik se ai nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi pamjaftueshmërinë financiare, në vlerën rreth 8,9 milionë lekë, të konstatuar fillimisht nga Komisioni, në rezultatet e hetimit. Sipas subjektit, konstatimi i kësaj difference negative, bie ndesh me klasifikimet korrekte kontabël të disa prej zërave e konkretisht:

a. shitja në tetor 2004 me vlerë 1.950.000 lekë e tokës arë [të përfituar nga familja në bazë të ligjit nr. 7501] dhe riblerja e tokës me të njëjën vlerë në shtator 2005, është neutral ekonomikisht dhe, për këtë arsye, nuk përfaqëson investim të bërë nga subjekti;

b. vlera e plotë e kredisë bankare prej afër 4,9 milionë lekësh, nuk duhet konsideruar e gjitha si detyrim i periudhës 01.07.2005 – 19.01.2009, por duhen pasqyruar vetëm këstet e paguara gjatë kësaj periudhe [interes + principal i maturuar];

c. investimi për fushën e minifutbollit nuk duhet kundërvendosur mekanikisht me çmimin e shitjes së tokës prej 3 milionë lekësh. Vlera e shpenzuar për investimin e pajisjeve ka rritur vlerën e pasurisë e, për rrjedhojë, duhet pasqyruar si e ardhur nga shitja e një aktivi të veçantë.

11.6. Pas kontrollit të ushtruar mbi vendimin objekt shqyrtimi, pretendimet e kundërpretendimet e palëve për pasurinë objekt kontrolli dhe nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, analizuar nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi se subjekti ka *mungesë* të burimeve financiare të ligjshme për likuidimin e një pjese të çmimit total prej 149.054 eurosh, referuar në kontratën e sipërmarrjes të datës 01.08.2008. Analiza financiare e kryer në Kolegji, rezultoi me një balancë negative prej (-) 9.361.744 lekësh, për blerjen e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të deklaruara për periudhën 01.07.2005 - 19.01.2009. Ky konkluzion vjen si rrjedhojë e problematikave të evidentuara në lidhje me burimet e krijimit të saj, shtjelluar në vijim.

11.7. *Së pari*, trupi gjykues e gjeti të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik për të përfshirë në mesin e të ardhurave të ligjshme nga shitja e tokës arë *vetëm* vlerën 3 milionë lekë, referuar në kontratën e shitblerjes dhe kartelën e pasurisë, *dhe jo* edhe shumën 47.000 euro të pretenduar nga shitja e investimit të kryer në fushën e minifutbollit. Ky konkluzion u bazua në situatën faktiko-ligjore që rezultoi nga shqyrtimi i akteve si më poshtë shtjelluar.

11.7.1. Ndërsa në deklaratën periodike për vitin 2009, subjekti ka deklaruar si burime për apartamentin kredinë [35.000 euro] dhe 95.000 euro nga shitja e një toke me investimin mbi të [fushën e minifutbollit dhe lokalit], në deklaratën *vetting* ai ka shtuar se çmimi 3.000.000 lekë në kontratën e shitjes, përbën vlerën fillestare, pasi sapo kishte nisur ndërtimi dhe nuk kishin ardhur pjesët. Sipas kësaj deklarate, shuma e investuar prej tij është 47.000 euro.

11.7.2. Nga aktet, rezulton se subjekti është bërë pronar i tokës me sipërfaqe 2.173 m² nga trashëgimia. Me kontratën e shitjes⁴², datë 05.11.2005, kjo pasuri iu është shitur dy individëve, kundrejt vlerës 3.000.000 lekë. Përpos kësaj vlere, në kartelën e pasurisë, trualli përshkruhet të ketë edhe një ndërtim me sipërfaqe 1.400 m². Nëna e subjektit ka likuiduar edhe detyrimin tatimor të përlllogaritur mbi vlerën 3.000.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes.

11.7.3. Subjekti ka pretenduar që ka porositur pajisjet e kompleksit nëpërmjet një personi juridik. Në shpjegimet në pyetësor dhe nëpërmjet akteve të përcjella në Komision⁴³, subjekti është shprehur edhe se ndërkohë që pajisjet po vonoheshin, ai shiti tokën dhe të drejtat e ndërtimit mbi të kundrejt çmimit 95.000 euro, ndonëse në kontratë palët ranë dakord të shënonin vetëm shitjen e tokës – ose vlerën 3.000.000 lekë. Pjesa tjetër e çmimit, sipas subjektit, do të likuidohej kur të vinin pajisjet e fushës. Në vitin 2006, shoqëria e kontraktuar prej tij [{"***"} ShPK] montoi pajisjet që kishte porositur

⁴² Nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.11.2005.

⁴³ Në ILDKPKI në datën 11.02.2015, dhe në Komision me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, duke bashkëlidhur dokumentet: (i) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.01.2017, e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe pala blerëse e pasurisë [truallit, fushës së minifutbollit dhe ambienteve ndihmëse]; (ii) deklaratë, datë 10.10.2016, e shoqërisë [{"***"} ShPK [shkresë e thjeshtë]; (iii) dokument të shoqërisë [{"***"} ShPK, të titulluar "Ofertë", për artikuj dhe zëra punimesh për ndërtimin e fushës së minifutbollit, me vlerë totale 50.428 euro, oferta e mbyllur në shumën 47.000 euro.

subjekti. Në këtë moment, subjekti mori edhe diferencën prej 70.000 eurosh. Këto pretendime mbështeten edhe nga deklaratat noteriale e dorëzuar në Komision, hartuar nga subjekti dhe blerësit në datën 23.01.2017, katër ditë përpara dorëzimit të deklaratës *vetting*. Sipas saj, blerësit kanë shlyer gradualisht diferencën e çmimit, vlerën 70.000 euro, ndërsa shitësi/subjekti kryente investimet. Prona, sipas deklaratës, ishte e pazhvilluar.

11.8. Trupi gjykues vëren se kjo deklaratë vjen në kundërshtim me kontratën e shitblerjes. Konkretisht, në kontratën e shitjes të vitit 2005, përcaktohet se objekti i shitjes ishte trualli *dhe ndërtesa* që ndodhej mbi të, sipas certifikatës së pronësisë bashkëlidhur. 12 vjet më pas, në deklaratën noteriale pretendohet se ndërtimi ishte i pakryer. Kontrata po ashtu nuk referon asnjë rrethanë që të konfirmojë pretendimet e subjektit për fitimin në total të 95.000 eurove prej kësaj pasurie, apo për mënyrën e likuidimit. Edhe detyrimet tatimore në vijim të kontratës së shitjes referojnë dhe janë kryer për shumën 3.000.000 lekë. Kjo nënkupton që nëse vërtet subjekti ka fituar edhe shumën 70.000 euro, përpos asaj për të cilën palët kanë hartuar aktet ligjore, nuk përmbush kriterin e ligjshmërisë në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, edhe nëse abstragohet nga problematikat e evidentuara në planin ekzistencial të këtyre të ardhurave, argumentuar më lart.

11.9. Bazuar në konstatimet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti dështoi të provojë përfitimin e shumës totale prej 95.000 eurosh në vitin 2005, të pretenduar nga shitja e tokës bashkë me lokalit dhe fushën e minifutbollit mbi të, deklaruar si burim krijimi për apartamentin objekt kontrolli. Për rrjedhojë, në analizën e kryer në Kolegj, duke e gjetur të bazuar këtë shkak ankimi, trupi gjykues përfshiu vetëm shumën 3 milionë lekë sipas kontratës së shitjes, pasqyruar e konfirmuar edhe nga pagesa e detyrimeve tatimore që passjell ky transaksion. Nga ana tjetër, është e pabazuar qasja e zgjedhur nga Komisioni për të përfshirë një vlerë konsiderueshëm më të lartë, që bie ndesh me aktet dhe bazohet krejtësisht në pretendimet deklarative të subjektit. Subjekti nuk ka sjellë asnjë akt shkresor të kohës që të referojë qoftë edhe indirekt, një vlerë të ndryshme nga ajo e dakordësuar nga palët në kontratën e shitjes, kartelën e pasurisë, apo ajo për të cilën subjekti ka shlyer detyrimet tatimore, që është vlera 3 milionë lekë. Nuk rezulton asnjë klauzolë apo referencë në kontratën e hartuar nga palët që të mbështesë pretendimet e subjektit për përfitimin prej tij të 95.000 eurove, apo për mënyrën e likuidimit të kësaj vlere të pretenduar.

11.10. Deklarata noteriale e hartuar në datën 23.01.2017, në krye të procesit të rivlerësimit, mbi 11 vjet pasi pretendohet të ketë ndodhur pagesa në fjalë që referon likuidimin e vlerës shtesë prej 70.000 eurosh për investimin, u vlerësua me probleme të qenësishme *besueshmërie*, jo vetëm për shkak të kohës kur është kryer, por edhe sepse nuk shpjegon përse palët nuk i kanë formalizuar veprimet e referuara në një akt noterial gjatë momentit të tjetërsimit të pasurisë. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të pambështetur në akte, pretendimin e subjektit dhe vlerësimin e Komisionit për të përfshirë në mesin e të ardhurave të ligjshme totalin ekuivalent të vlerës 95.000 euro, përkundër asaj të pasqyruar në dokumentacion. Trupi gjykues i Kolegjit i gjen jobindëse shpjegimet e subjektit pasi vëren se rrethanave të parashtruara prej tij, u mungon logjika ekonomike. Në kushtet që pretendohet se subjekti ka investuar 47.000 euro për këtë pasuri, gjatë vitit 2006, kur nuk ishte më pronar, është e pakuptimtë përse këtë shpenzim duhet ta përballonte ai e rimburshej më pas nga blerësit, të cilët mund të kujdeseshin vetë për këtë investim, tashmë pronë e tyre, pa krijuar një trekëndësh palësh për veprimet që po kryheshin dhe likuidimin e shpenzimeve [shoqëria “{***}” ShPK – subjekti i rivlerësimit – blerësit].

11.11. Trupi gjykues e gjen të bazuar pretendimin e Komisioneres Publike dhe të përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për sa i përket shumës 8.590.717 lekë, të shtuar nga Komisioni në mesin e burimeve financiare të disponuara nga subjekti në vendim. Ky konkluzion vjen si rrjedhojë e problematikave të konstatuara, shtjelluar në vijim.

11.12. Së pari, kjo shumë nuk renditet ndër burimet e deklaruara për krijimin e pasurisë objekt analize. Në të vetmen deklaratë të mëhershme ku subjekti shprehet për kursime, ajo e dorëzuar më 30.06.2005 [si OPGj], subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*. Ai ka deklaruar vetëm një llogari në Bankën Amerikane prej 3.000.000 lekësh. Kursimet e tjera i përkasin harkut kohor pas vitit 2008, kur ka porosituar apartamentin. Duke iu rikthyer deklaramit në vitin 2005, subjekti ka deklaruar të ardhura por jo kursime, e konkretisht: qiranë vjetore 36.000 USD për vitet 2000 – 2004 dhe të ardhura nga pagat e tij e bashkëshortes, përkatësisht në shumat 820.800 lekë dhe 360.000 lekë. Mosdeklarimi i kursimeve në deklaratën periodike të pasurisë, në linjë me arsyetime të mëparshme të Kolegjit⁴⁴, e bën të pamundur të prezumohet ekzistenca e tyre në proces, vite më pas apo mbështetur në nivel teorik në balanca pozitive. Kursimet duhet të jenë specifikuar në deklaratat periodike të interesave, të cilat shërbejnë si provë në këtë proces, që janë prova e vetme mbi të cilën provohet ekzistenca e likuiditeteve *cash* në banesë, sidomos nëse pretendohen se kanë shërbyer për krijim pasurish.

11.13. Përpos sa më sipër, në kushtet që këto kursime nuk deklarohen si burim për apartamentin objekt vlerësimi, as në deklaratën periodike të kohës të vitit 2009 dhe as në deklaratën *vetting*, qëndrimi i Komisionit për të shtuar likuiditete të padeklaruara si burim, pa asnjë arsyetim dhe analizë për mënyrën sesi u krijua e u prezumua nga Komisioni, është edhe i pakuptimtë dhe përbën favorizim të konsiderueshëm. As vetë subjekti nuk e ka pretenduar këtë shumë gjatë hetimit administrativ, madje ai nuk e argumentoi atë as në Kolegji, në parashtrimet apo bisedimet përfundimtare, në të cilat ka heshtur për këtë aspekt ankimi, duke potencuar vetëm që e konsideron këtë shumë si rrjedhojë e trajtimeve metodologjike të pasakta, pa dhënë sqarime apo pretendime konkrete mbi sa pretenduar nga Komisioneri Publik⁴⁵. Kjo qasje e Komisionit vjen në kundërshtim edhe me praktikën orientuese⁴⁶ të Kolegjit, për të mos prezumuar përdorimin e likuiditeteve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë ky aspekt nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të pasurisë. E thënë më thjesht, edhe duke abstraguuar nga sa më sipër e të pranohej “hipotetikusht” që subjekti apo Komisioni i identifikojnë kursimet e tjera të mundshme me të ardhurat nga “{***}”, asgjë nuk do të ndryshonte në rezultatin final, pasi këto të ardhura, në deklaratën *vetting* janë identifikuar si burim vetëm për investimin prej 47.000 eurosh, por jo për apartamentin objekt analize.

11.14. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se përfshirja e shumës prej 8.590.717 lekësh, titulluar “kursime të tjera të mundshme”, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, bie ndesh me faktet që rezultojnë nga aktet në fashikull dhe me jurisprudencën e Kolegjit. Konkretisht, përveçse nuk argumentohet se nga origjini, kjo shumë nuk ka gjetur pasqyrim si gjendje *cash*-i jashtë apo në sistemin bankar as në deklaratën e pasurisë për vitin 2004, sikurse as

⁴⁴ Ndër të tjerë, vendimi nr. 7/2025, që i përket subjektit të rivlerësimit I. T. apo nr. 7/2019 që i përket subjektit të rivlerësimit E. S.

⁴⁵ Faqe nr. 15 e parashtrimeve të subjektit, pika nr. 49, paragrafi i dytë dhe faqe nr. 10 e bisedimeve përfundimtare, pika nr. 36, paragrafi i dytë.

⁴⁶ Vendimi nr. 7/2019 që i përket subjektit të rivlerësimit E. S., paragrafi 35.

është pretenduar nga subjekti në ndonjë fazë të procesit të rivlerësimit, përfshirë edhe bisedimet përfundimtare të depozituara në Kolegj. Referuar vlerës provuese që kanë deklaratat periodike vjetore në procesin e rivlerësimit dhe jurisprudencën e Kolegjit në interpretim të këtij përcaktimi ligjor, ekzistenca e kursimeve nuk mund të prezumohet mbështetur vetëm në balancat pozitive *teorike/hipotetike*. Me fjalë të tjera, ndonëse subjekti nuk ka deklaruar *cash* në deklaratën periodike që përkon me kohën në fjalë, përpos që kjo shumë likuiditetesh nuk është deklaruar si burim krijimi për pasuritë objekt analize në deklaratën e pasurisë të vitit 2009, në deklaratën *vetting* apo gjatë hetimit administrativ, prezantimi i kësaj shume të pashpjeguar nga Komisioni në vendim, përbën një favorizim të subjektit të pambështetur në prova, të paarsyetuar dhe të pabazuar. Përfshirja e “kursimeve të tjera të mundshme” në analizën financiare të apartamenteve dhe garazheve, vjen në kundërshtim edhe me praktikën orientuese të Kolegjit për të mos prezumuar përdorimin e likuiditeteve *cash* të padeklaruara se ekzistojnë si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të shprehur nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të pasurisë.

11.15. Trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të bazuar pretendimin e Komisioneres Publike dhe të përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës për pamjaftueshmëri financiare në vlerën rreth 8,9 milionë lekë, të konstatuar fillimisht nga Komisioni. Ndryshe nga sa pretendon subjekti, Komisioni nuk ka bërë klasifikim kontabël të gabuar të zërave të potencuar. Konkretisht, pretendimi se shitja në tetor 2004, me vlerë 1.950.000 lekë, e tokës arë dhe riblerja e tokës me të njëjën vlerë në shtator 2005, është neutral ekonomikisht dhe nuk përfaqëson investim të bërë nga subjekti, është i pabazuar në kushtet kur shitja dhe blerja e tokës janë fakte të pranuar nga subjekti, të deklaruara nga ai dhe të pasqyruara nga Komisioni. I pabazuar është edhe pretendimi se vlera e plotë e kredisë bankare prej afër 4,9 milionë lekësh, nuk duhet konsideruar e gjitha si detyrim i periudhës 01.07.2005 - 19.01.2009, por duhen pasqyruar vetëm këstet e paguara gjatë kësaj periudhe [interes + principal i maturuar]. Rezultoni se kredia është marrë në vitin 2008 për blerjen e apartamentit dhe është përdorur po atë vit. Në çdo deklaratë, kjo kredi është deklaruar si burim për blerjen e apartamentit. Në vitet më pas, pasqyrohen vetëm shlyerjet e kësteve. Pas korrektimit të analizës së Komisionit, duke mos pasqyruar të ardhurat nga shitja e investimit të pajisjeve të futbollit dhe të ardhurat e mundshme të kursyera, balanca negative për krijimin e kësaj pasurie përlllogaritet në vlerën (-) 8.999.070 lekë. Për sa më sipër, subjekti gjendet në situatën e përcaktuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 për të krijuar pasurinë objekt analize me të ardhura nga burime financiare të ligjshme.

I./3 Depozita me vlerë 13.000.000 lekë në Raiffeisen Bank, krijuar në vitin 2014

12. Këtë pasuri, subjekti e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*. Si burim, ai shprehet se kanë shërbyer bonot e thesarit, të krijuara nga shitja e një toke bujqësore në vlerën 10.000.000 lekë sipas kontratës së shitjes të datës 03.10.2007 dhe 210.000 euro të përfituara nga shitja e një tjetër toke bujqësore, me sipërfaqe 1.750 m², sipas kontratës së shitjes, datë 4 janar 2013.

12.1. Komisioni vlerësoi përfundimisht për këtë pasuri, se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e pasurisë objekt vlerësimi, fondit të investimit, pranë Raiffeisen Invest në deklaratën *vetting*. Ky vlerësim u bazua në konkluzionet për secilin burim krijimi si më poshtë vijon.

12.2. Në lidhje me burimin e parë, pasi ka pranuar shpjegimet e subjektit për mënyrën e krijimit të *bonove të thesarit*, përfundimisht Komisioni shprehet se nuk konstatoi problematika në transaksionet e blerjes/shitjes së tokës dhe që familja e subjektit ka pasur të ardhura nga punësimi e qiradhënia [me “{***}”], dhe të ardhura të tjera, përgjatë periudhës korrik 2005 - janar 2008, të cilat mundësojnë krijimin e depozitës 7 milionë lekë në Raiffeisen Bank. Komisioni ka pranuar shpjegimet e subjektit dhe ka përfshirë në mesin e burimeve të disponuara edhe të ardhurat nga shitja e një gjeneratori, deklaruar në deklaratën për vitin 2011, si burim për shtesën e bonove të thesarit. Komisioni pranoi shpjegimet e subjektit se çmimi i blerjes së tokës në vitin 2005, është vendosur nga palët në kontekstin e zgjidhjes miqësore të një konflikti pronësie mbi këtë tokë me familjarë të afërt të nënës së tij, ndërsa çmimi i shitjes përputhet me vlerat e tregut. Komisioni pranoi pretendimin se, për krijimin e kësaj depozite, kanë shërbyer edhe të ardhurat që disponoheshin *cash* prej familjes së tij, të krijuara nga marrëdhënia me shoqërinë “{***}”. Ndërsa, në lidhje me burimin e dytë – të ardhurat prej 210.000 *eurosh*, të përfituara nga shitja e një tjetër toke bujqësore – Komisioni nuk ka evidentuar problematika, në funksion të kontrollit të obligacioneve me afat 5-vjeçar në Bankën e Shqipërisë, krijuar në datën 08.05.2014, në vlerën 15.000.000 lekë.

12.3. Komisionerja Publike ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni. Ajo ngre dyshime mbi vërtetësinë e çmimit të shitjes së tokës bujqësore në vlerën 10.000.000 lekë, e cila, në vijim, ka shërbyer për krijimin e bonove të thesarit për shkak të çmimit të shitjes 13 herë më të lartë nga çmimi i blerjes, dhe me kartelën e pasurisë së paluajtshme, në të cilën kjo pasuri referohet me vlerë 10.000 lekë. Po ashtu, të ardhurat nga shoqëria “{***}”, potencon Komisionerja Publike, nuk plotësojnë kriterin e ligjshmërisë, sipas kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare, konfirmoi të njëjtin qëndrim.

12.4. Subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, pretendoi se nuk qëndrojnë dyshimet e Komisioneres Publike për fiktivitet të çmimit të shitjes së tokës. Çmimi i shitjes është real dhe fondet janë të evidentueshme në depozitimet bankare dhe investimet pasuese. Subjekti potencoi argumentet në prapësim të barrës së provës, pranuar bindëse nga Komisioni për arsyet për të cilat çmimi i blerjes pasqyrohet në një vlerë shumë të ulët – për shkak të një rregullimi mes pjesëtarëve/të afërmve të nënës së tij. Shitësit kishin përfituar pronësinë sipas ligjit nr. 7501/1991, mbi një truall që kishte qenë pronë e familjes së origjinës të nënës së tij, sikurse provon një vendim gjykate i vitit 2007 dhe akte të tjera të depozituara prej tij në Komision me prapësimet kundër rezultateve të hetimit⁴⁷. Çmimi i shitjes në vitin 2007, është brenda vlerave të tregut, pasi kufijtë dhe titujt e pronësisë ishin konsoliduar. Konstatimi i Komisionit se të ardhurat nga shitja e tokës në tetor 2007, nuk mjaftonin për krijimin e depozitës 7.000.000 lekë në vitin 2008, është i drejtë. Ky konstatim është bazuar në një pasaktësi formale deklarimi në deklaratën për vitin 2009. Diferenca është mbuluar nga të ardhurat e përfituara nga shoqëria “{***}”, të akumuluar në *cash* dhe nga veprimet bankare të dokumentuara. Të ardhurat e realizuara nga marrëdhënia me këtë shoqëri, janë të ligjshme e duhen pranuar. Shtesa prej 3.000.000 lekësh në bono thesari në vitin 2011, e cila e çoi totalin e fondeve financiare në vlerën 13.000.000 lekë, përfshin edhe të ardhurat prej 1.300.000 lekësh nga shitja e gjeneratorit, dhuruar familjes së subjektit pas largimit të shoqërisë qiramarrëse. Kjo shumë u depozitua në Bankën Intesa

⁴⁷ Vendimi nr. {***}, datë 26.12.2007, i Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me hartat përkatëse dhe i konfirmuar nga një prej palëve shitëse në deklaratën noteriale të depozituar në Komision.

Sanpaolo dhe është pasqyruar në deklaratën periodike të vitit 2011, me përshkrimin “e ardhur familjare”, sepse nuk përbënte të ardhur individuale të subjektit dhe as të bashkëshortes së tij.

12.5. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Kolegj, bazuar në aktet në fashikull, dhe në vijim të qëndrimeve të referuara më sipër, balanca negative për krijimin e kësaj pasurie mbeti e konsiderueshme. Ky konkluzion qëndron edhe pasi trupi gjykues vlerësoi që të mos i përjashtojë të ardhurat e krijuara nga shitja e dy pasurive të tjera të paluajtshme [toka] që janë deklaruar si burim për këtë pasuri. Analiza mbi të cilën u mbështet ky vlerësim, shtjellohet në vijim.

12.6. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo pasuri ka për burim fonde/*bono thesari* nga shitja e dy parcelave tokë bujqësore e truall në vitet 2007 dhe 2013, në vlerat respektive 10 milionë lekë dhe 210.000 euro. Përpos këtyre të adhurave, subjekti shtoi burime të reja pas kalimit të barrës së provës, e konkretisht të ardhura që disponoheshin *cash* prej familjes së tij, të krijuara nga marrëdhënia me shoqërinë “{***}” dhe të ardhura nga shitja e një gjeneratori. Këto dy burime të reja, të shtuara pasi subjekti u njoh me rezultatet e hetimit, u gjetën me problematika në Kolegj, të cilat ngrenë pikëpyetje të qenësishme për besueshmërinë e shpjegimeve të subjektit. *Së pari*, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se, sikurse konstatuar edhe nga Komisioni në rezultatet e hetimit, analiza e historikut të depozitimit të shumave dhe veprimeve bankare, ka treguar që të ardhurat nga shitja e parcelës së parë, në funksion të depozitimit që ka ushqyer bonot e thesarit deri në vitin 2011, *nuk mund* të përbënin burim krijimi për pasurinë objekt analize, pasi ato janë përdorur për *qëllime të tjera*⁴⁸.

12.7. Nga ana tjetër, edhe burimet që subjekti pretendoi në prapësim të rezultateve të hetimit, e konkretisht *cash*-i në banesë, në vlerën 6 milionë lekë⁴⁹, me burim nga të ardhurat e tij nga “{***}”, do të ishte e pamjaftueshme pasi kjo shumë është përdorur edhe për blerjen e dy tokave bujqësore në vitet 2002, 2003 dhe 2005, përkatësisht kundrejt çmimit 480.000 lekë dhe 1.300.000 lekë. Sikurse analizuar gjerësisht për sa u përket përfitimeve nga punësimi i subjektit me kohë të pjesshme pranë “{***}”, trupi gjykues i Kolegjit përfshiu në analizën e burimeve të ligjshme të disponuara nga subjekti i rivlerësimit *vetëm* vlerën 6.395.900 lekë [ekuivalenti i shumës 52.000 USD], që përbën vlerën e të ardhurave të provuara. Nga kjo qasje, rezulton se të ardhurat prej 6.395.900 lekësh, janë përdorur pjesërisht për krijimin e pasurive të mësipërme dhe pjesërisht për krijimin e depozitës objekt kontrolli. Në këto kushte, nga shuma totale prej 6.000.000 lekësh [si pjesë e bonove të thesarit në

⁴⁸ Shih rezultatet e hetimit administrativ, faqet 43 - 45. Nga konfermat bankare, rezulton se në datën 17.10.2007, shuma prej 8.600.000 lekësh në këtë llogari, është investuar në depozitë në shoqërinë kursim krediti “{***}”. Pjesë e këtyre të ardhurave, 5.000.000 lekë, janë përdorur në qershor 2008 për likuidim detyrimi për blerje pasurie të paluajtshme. Shuma prej 3.600.000 lekësh ka qenë e investuar në Raiffeisen Bank deri në korrik të vitit 2008, pastaj depozitë në Credins Bank deri në shkurt të vitit 2009. Pjesa prej 1.000.000 lekësh, e depozituar *cash* në këtë llogari nga blerësi i parcelës së parë në datat 3-4 dhjetor 2012, është tërhequr *cash* nga subjekti brenda datës 20.12.2007. Për shumën 400.000 lekë (diferenca nga shitja e tokës, ndërmjet shumës 10.000.000 – 8.600.000 – 1.000.000) nuk gjenden gjurmë në llogaritë bankare.

⁴⁹ Në faqen 26 të prapësimeve kundër rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se pranon pasaktësinë në deklaram dhe ka referuar se depozita prej 7.000.000 lekësh është krijuar edhe me të ardhurat që disponoheshin *cash* prej familjes së tij – me burim marrëdhënien financiare me shoqërinë “{***}”. Sipas shpjegimeve, depozita prej 7.000.000 lekësh është krijuar nga bashkimi i dy depozitave pranë Bankës Raiffeisen, respektivisht në vlerat 2.900.000 lekë dhe 4.100.000 lekë. Shuma prej 2.900.000 lekësh ka si burim: 1.000.000 lekë nga nga të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës me sip. 1.462 m², në tetor 2007 dhe 1.900.000 lekë nga të ardhurat e përfituara nga shoqëria “{***}”, të mbajtura *cash* nga nëna. Edhe shuma prej 4.100.000 lekësh që i është bashkuar shumës së mësipërme në datën 19.01.2008, duke krijuar shumën 7 milionë lekë, është krijuar nga të ardhurat e përfituara nga shoqëria “{***}”. Sipas këtij shpjegimi, rezulton se nga shuma totale prej 7.000.000 lekësh, shuma prej 6.000.000 lekësh ka si burim të ardhurat e përfituara nga shoqëria “{***}”.

vlerën 7.000.000 lekë], subjekti nuk justifikon me burime të ligjshme shumën prej (-) 1.384.100 lekësh.

12.8. *Së dyti*, trupi gjykues e gjeti të bazuar pretendimin në ankim dhe në parashtrimet e përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, për të mos përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara, vlerën 1,3 milionë lekë të pretenduara nga shitja e një *gjeneratori*. Kjo shumë rezulton e padeklaruar në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *vetting*, ndërsa në prapësime subjekti e ka cilësuar si pjesë e të ardhurave familjare vjetore në deklaratën periodike për vitin 2011. Ndërsa, në atë deklaratë, subjekti ka deklaruar të ardhura familjare, si burim për shtesën e bonove të thesarit, ai nuk ka specifikuar shumën konkrete, përkatësinë/pronësinë dhe burimin/origjinën e tyre. Nga ana tjetër, rezulton se subjekti është kontradiktor në shpjegime e pretendime. Ndërkohë që ai e trajton këtë fond si pasuri personale, duke e depozituar në *cash* në llogarinë e tij në bankë, pretendon nga ana tjetër se ai nuk është pasuri e tij, pavarësisht se në deklaratat periodike të kohës, të ardhurat e nënës referohen vetëm ato nga pensioni i saj.

12.9. Në një lexim logjik dhe harmonik të këtyre akteve, deduktohet që të ardhurat familjare që kontribuuan në shtesën e bonove të thesarit në vitin 2011, përfshinin edhe të ardhurat e nënës nga pensioni, ndërsa përjashtohen të ardhura të tjera. Edhe duke abstraguar nga problematika e mosdeklarimit të të ardhurave nga shitja e gjeneratorit në cilëndo formë, qoftë si e ardhur personale, qoftë si e ardhur e nënës, subjekti ka konfirmuar⁵⁰ se *nuk* disponon dokumentacion provues për këtë shitje. Si rrjedhojë, këto pretendime mbeten në nivel deklarativ në tërësi, duke përjashtuar edhe teorikisht nevojën për të analizuar ligjshmërinë e tyre. Për sa më sipër, në ndryshim nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme, në funksion të krijimit të shumave monetare që kanë ushqyer këtë depozitë, vlerën prej 1,3 milionë lekësh *cash* të depozituar në llogarinë e tij të pagës, në vitin 2011, pretenduar me burim shitjen e një *gjeneratori*. Në kushtet që subjekti nuk e ka deklaruar fitimin e këtyre të ardhurave në deklaratën periodike përkatëse apo në deklaratën *vetting* dhe as e ka provuar me dokumentacion përfitimin në fjalë, ky pretendim për origjinën e *cash*-it të depozituar në llogarinë e tij të pagës, referuar për herë të parë në shkurt 2015, pasi është pyetur nga ILDKPKI-ja, u vlerësua deklarativ.

12.10. *Së treti*, në lidhje me vërtetësinë e çmimeve të transaksioneve blerje/shitje të tokës në vitet 2005/2007, në vlerat 760.000 lekë/10 milionë lekë, rezulton se subjekti i rivlerësimi, në datën 27.06.2005 ka blerë⁵¹, një tokë arë me sipërfaqe 1.462 m², ndodhur në {***}, Durrës, kundrejt çmimit 760.000 lekë të likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale. Në datën 03.10.2007, e njëjta pasuri i është shitur⁵² një tjetër individ. Në këtë kontratë shitjeje, çmimi i pasurisë është shënuar me shifra 10.000 lekë, ndërsa me përshkrim narrativ, “dhjetë milion lekë”. Në kartelën e pasurisë së paluajtshme, rezulton e pasqyruar kronologjia e pronës, kontratat e blerjes dhe të shitjes dhe çmimi i blerjes prej 760.000 lekësh, ndërsa ai i shitjes në vitin 2010 shënohet me vlerën 10.000 lekë. Komisionerja Publike dhe përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme i referohen vlerës 10.000 lekë, të specifikuar në kartelën e pasurisë, si argument për dyshimin e tyre se çmimi i shitjes së tokës mund të ketë qenë fiktiv. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndonëse çmimi i shitjes i është referuar kontratës së shitjes [përfshirë edhe ekstremiteteve të saj], ai është shënuar në vlerën 10.000 lekë sipas

⁵⁰ Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, në datën 11 shkurt 2015.

⁵¹ Me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.06.2005.

⁵² Me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.10.2007.

përshkrimit të bërë në kontratë me shifra, duke ometuar përshkrimin narrativ “10 milionë”. Në kushtet që përpilimi i akteve zyrtare është detyrë dhe tagër e institucioneve të ngarkuara, kjo mosërputhje mes shifrës e përshkrimit narrativ nuk do të ishte e objektive t’i ngarkohej me pasojë subjektit.

12.11. Nga aktet, rezulton po ashtu se në datën 04.10.2007, blerësi ka depozituar në llogarinë bankare të subjektit shumën 7.500.000 lekë, me përshkrimin “likuidim”. Pas pesë ditësh, në datën 09.10.2007, subjekti ka depozituar *cash* 1.100.000 lekë, shumë e cila, sipas shpjegimit të tij⁵³, buron nga kontrata e shitjes së tokës në tetor 2007. Dy muaj më pas, në datat 3 dhe 4 dhjetor 2007, blerësi ka derdhur në llogarinë rrjedhëse të subjektit shumat 900.000 lekë dhe 100.000 lekë. Sa më sipër, rezulton që blerësi ka derdhur në bankë për llogari të subjektit, më së paku shumën 8,5 milionë lekë, nga 10 milionë të specifikuar në kontratën e shitblerjes. Referuar shkresës të AShK-së⁵⁴ dhe mandatit, datë 17.10.2007, bashkëlidhur saj, subjekti ka likuiduar tatimin në shumën 50.000 lekë, që i korrespondon masës 0,5% të çmimit të shitjes së tokës bujqësore arë, prej 10.000.000 lekësh, të përcaktuar në kontratë, sipas parashikimit në aktet ligjore të kohës⁵⁵.

12.12. Trupi gjykues konstaton se çmimi i blerjes prej 760.000 lekësh në vitin 2005 dhe ai i shitjes prej 10 milionë lekësh në vitin 2007, janë dukshëm të ndryshëm nga çmimet e referencës të përcaktuara në VKM-në nr. 139/2008 si akti më i afërt në kohë⁵⁶. Sipas këtij vendimi, çmimi i referencës për tokat bujqësore në Shkallnur, në vitin 2008, ka qenë 899 lekë/m², ndërsa vlera e pasurisë me sipërfaqe 1462 m², e përllogaritur mbi këtë çmim reference për vitin 2008, do të rezultonte në vlerën 1.314.338 lekë. Si akti më i përafërt në kohë, prezumohet se e njëjta vlerë reference ka qenë edhe për vitet 2005 apo 2007. Komisioni nuk rezulton të ketë bërë një analizë nëse subjekti i rivlerësimit kishte mundësi financiare për blerjen e tokës në vitin 2005, në vlerën sipas çmimeve të referencës apo edhe me çmimin 760.000 lekë, çka do të hidhte më shumë dritë për të qartësuar dyshimet mbi fiktivitetin e çmimit në kahun e blerjes nga subjekti. Në vendim, Komisioni ka arsyetuar vetëm që i ka gjetur të besueshme dhe të provuara, pretendimet e subjektit se çmimi i blerjes ishte deduksion i marrëdhënies së posaçme të subjektit me shitësit e kësaj pasurie. Nga ana tjetër, ankimi ka për fokus vetëm dyshimin për fiktivitet të çmimit të *shitjes* së tokës, dhe jo për atë të blerjes. Për sa më sipër, trupi gjykues e gjen pa relevancë trajtimin e pretendimeve të parashtruara në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me çmimin e blerjes në vitin 2005 dhe rrethanat e marrëdhënies familjare për shkak të të cilave blerja ka qenë në vlerën e përcaktuar në kontratën nëpërmjet së cilës ai fitoi pronësinë.

12.13. Dyshimi për fiktivitet parashtrohet vetëm si derivat i diferencës mes dy çmimeve që ka passjellë fitimin e konsiderueshëm nga subjekti dhe mospërputhjen me kartelën e pasurisë së paluajtshme, të lëshuar në emër të blerësit, ku toka referohet me vlerë thujtse të papërfillshme, prej 10.000 lekësh. Në këto kushte, për efekt të vlerësimit në Kolegj, paraqesin rëndësi në zgjidhjen e çështjes rrethanat ligjore si pasojë e të cilave subjekti ka krijuar shumën e të ardhurave, si dhe

⁵³ Në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

⁵⁴ Shkresa e AShK-së “Kthim përgjigje” drejtuar subjektit, depozituar në Komision me e-mail, datë 22.02.2024.

⁵⁵ Në udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar”, në pikën 2.3.7, “Të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme [...] tatohen sipas tabelës nr. 2 të ligjit, me përjashtim të transferimit të së drejtës së pronësisë së tokës bujqësore që tatohet me 0,5% të vlerës së transaksionit [...]”.

⁵⁶ Në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtimit të Ponave (<https://atp.gov.al/hartat-e-vleres-nder-vite/>), janë publikuar hartat e vlerës për vitet 2006 - 2014. VKM nr. 816/2006, VKM nr. 555/2007 dhe VKM nr. 653/2007, nuk referojnë çmime reference për qarkun Durrës.

besueshmëria e tyre. Duke abstraguar nga fakti që pasqyrimi saktësisht i të dhënave në kartelën e pasurisë është përgjegjësi e institucioneve të ngarkuara me këtë sektor, trupi gjykues vëren se në kushtet që subjekti ka paguar tatimet për vlerën e kontratës e jo për atë të *kartelës* së pasurisë, çmimi i referuar në këtë të fundit, duhet të prezumohet se është rrjedhojë/vazhdim i pasaktësisë në shifra, por jo në përshkrimin e shkruar me fjalë në kartelë. Konkretisht, duket më e kuptimtë që çmimit me shifra t'i mungojnë shifrat [tri zero] krahasuar me përshkrimin narrativ – i cili referon 10 milionë lekë. Për më tepër, vlera 10.000 lekë/me shifra është në disproporcion edhe me vlerën e blerjes nga subjekti [760.000 lekë], pasqyruar në kartelë, sikurse edhe në disproporcion me vlerën që do të rezultonte sipas çmimit të referencës⁵⁷.

12.14. Për sa më sipër, në gjendjen që janë aktet, kërkimi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për t'i bërë pjesë të vlerësimit tërësor të çështjes dyshimet për fiktivitet të çmimit të shitjes, u vlerësua i pabazuar. Në linjë me qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit se fiktiviteti i çmimeve duhet verifikuar në të dyja kahet e transaksionit, dhe duke mbajtur në konsideratë që Komisioni nuk ka hetuar për dyshimin për fiktivitet të çmimit në blerjen e tokës nga subjekti dhe as është *shkak ankimi*, ndonëse rrethanat për marrëdhënie të posaçme me shitësit, nuk gjejnë pasqyrim në kontratën e hartuar mes palëve më 27.06.2005, sikurse as nuk ka akte që të provojnë shpjegimet e subjektit. Pavarësisht nga diferenca e dukshme ndërmjet çmimit të blerjes dhe çmimit të referencës të EKB-së për zonën, Komisioni gjithashtu nuk ka kryer analizë financiare mbi mundësinë e subjektit për përballimin e shpenzimeve sipas çmimeve të referencës apo edhe me çmimin 760.000 lekë. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nuk identifikohen elemente të mjaftueshme për ta ngritur dyshimin për çmim të pavërtetë, në nivelin e konkluzionit. Nga ana tjetër, ndonëse të ardhurat e përfituara nga shitja e dy parcelave të tokës, u përfshinë në analizë financiare në funksion të krijimit të pasurive për të cilat ato realisht kanë shërbyer, ato *nuk* kanë efekt në krijimin e pasurisë objekt analize.

12.15. Për sa i përket parcelës tjetër, me sipërfaqe 1.750 m², shitur me kontratën e datës 04.01.2013, në vlerën 210.000 euro, e cila ka shërbyer si burim për krijimin e depozitës Raiffeisen Invest, me vlerë 13 milionë lekë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ankuesit e kanë shkëputur këtë aspekt nga grupi i pretendimeve të ngritura për këtë depozitë. Konkretisht, në ankim, në kreun III, “Çështje të tjera”, ankuesit ngrenë dyshime mbi ligjshmërinë e të ardhurave nga shitja e kësaj pasurie në kuptim të nenit pasi në kartelën e saj nuk referohet asnjë vlerë e shumës së paguar për blerjen. Komisionerja Publike ka kërkuar që të bëhet pjesë e vlerësimit tërësor të subjektit nga Kolegji, së bashku me shkaqet e tjera në ankim.

12.16. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi shkaqet e ankimit duke potencuar se (i) prona është përfituar nëpërmjet trashëgimisë nga i ati, i cili e kishte përfituar në bazë të ligjit nr. 7501/1991; (ii) transaksioni prej 210.000 eurosh është kryer nëpërmjet dy transfertave bankare, respektivisht 21.000 euro në datën 26.11.2012 dhe 189.000 euro në datën 04.01.2013; (iii) kartela e pasurisë së paluajtshme ka funksion regjistruar për të drejtat reale dhe barrët e pasurisë, ndërsa çmimi provohet me aktin noterial të shitblerjes dhe dokumentacionin fiskal shoqëruar. Për rrjedhojë, mungesa e çmimit të shitjes në kartelën e pasurisë së paluajtshme, nuk mund të zëvendësojë provën primare që rrjedh nga akti noterial i shitjes për sa i përket çmimit dhe kalimit të së drejtës; (iv) shumat prej

⁵⁷ Përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 139/2008.

210.000 eurosh plotëson kërkesat e ligjshmërisë. Ajo është deklaruar saktë dhe i është nënshtruar pagesës së detyrimit tatimor.

12.17. Nga analiza e akteve në fashikull dhe parashtrimeve të palëve në seancë nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i Komisioneres Publike dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme është i pabazuar. Ky vlerësim u bazua në situatën faktiko-ligjore që rezultoi nga shqyrtimi i akteve në funksion të pretendimeve dhe kundërpretendimeve të palëve në këtë proces, shtjelluar në vijim.

12.18. Trupi gjykues vëren se, sikurse ka potencuar edhe subjekti, kjo pasuri i ka kaluar atij për shkak të të qenit trashëgimtar ligjor i të atit dhe në vijim të përfitimit për shkak të zbatimit të ligjit nr. 7501/1991 dhe AMTP-së. Në datën 4 janar 2013, subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij ia kanë shitur⁵⁸ këtë tokë, të konvertuar në truall, një personi juridik, kundrejt çmimit 210.000 euro, ekuivalenti i 29.400.000 lekë, referuar kursit të këmbimit euro-lekë në kontratë. Palët kontraktore kanë parashikuar edhe që çmimi minimal fiskal prej 8.400 lekësh/m², i përcaktuar në VKM-në nr. 1620/2008, është vetëm për efekt të përllogaritjes së tatimit për fitimin nga shitja e kësaj pasurie të paluajtshme. Në kartelën e pasurisë së paluajtshme⁵⁹, pasqyrohet shitja e kësaj pasurie në bazë të kontratës noteriale datë 04.01.2013, por jo shuma e paguar.

12.19. Kontrata e shitjes është raportuar nga noteri, konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave në vlerën e dakordësuar dhe me shënimin se likuidimi është kryer me transferta bankare. Dokumentacioni bankar konfirmon dy transferta të blerësit/personi juridik në favor të subjektit, me përshkrimin përkatës, në total 210.000 euro – përkatësisht transferta 21.000 euro në datën 26.11.2012 [rreth një muaj para kontratës] dhe 189.000 euro, kryer në datën 04.01.2013 [në të njëjtën datë me kontratën]. ASHK-ja ka konfirmuar se subjekti ka likuiduar detyrimin tatimor prej 840.000 lekësh, dhe ka bashkëlidhur mandatin bankar të datës 09.01.2013. Referuar akteve ligjore në fuqi⁶⁰ në datën 04.01.2013, për pasuritë e shitura me çmim mbi 6.000.000 lekë, tatimi përllogaritej në 3% të çmimit të shitjes. Detyrimi tatimor që ka paguar subjekti, 840.000 lekë, është ekuivalenti i 3% të çmimit të shitjes prej 29.400.000 lekë të përcaktuar në kontratë. Në këtë mënyrë, subjekti ka provuar pagimin e detyrimeve tatimore.

12.20. Me të njëjtin arsyetim si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, ndryshe nga ankuesit, nuk identifikon prova që vërtetojnë dyshimet për fiktivitetin e çmimit të shitjes së parcelës tjetër, në vitin 2013, në vlerën 210.000 euro. Ankuesi potencon fiktivitet të çmimit të shitjes bazuar vetëm në faktin se ai [çmimi] nuk gjen pasqyrim në kartelën e pasurisë, lëshuar në emër të blerësve. Sikurse arsyetuar për kontradiktat në të dhëna që pasqyron kartela e pasurisë tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe në këtë rast, mungesa e çmimit në kartelë është e pamjaftueshme në vetvete që e vetme të mbështesë objektivisht e bindshëm, dyshimin për fiktivitet të çmimit të përcaktuar në kontratën e shitblerjes, parë në balancë me aktet e tjera që provojnë të kundërtën. Konkretisht: (i) në kontratën e shitblerjes së datës 04.01.2013, ku palët kanë parashikuar që çmimi i shitjes është 210.000 euro ose 29.400.000 lekë; (ii) subjekti ka paguar detyrimet tatimore që përkojnë me vlerën sipas kontratës;

⁵⁸ Kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.01.2013 [depozituar nga subjekti bashkëlidhur deklaratës vetting].

⁵⁹ Përcjellë në ILDKPKI nga ish-ZVRPP Durrës.

⁶⁰ Neni 11 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat".

(iii) vlera e shitjes dhe pagesa është konfirmuar nga aktet shkresore, përfshirë edhe nëpërmjet veprimeve noteriale dhe likuidimit nëpërmjet transfertave bankare.

12.21. Në përfundim dhe si përmbledhje e sa më sipër, nga kontrolli në Kolegj i analizës financiare të kryer nga Komisioni, subjekti rezultoi me një balancë negative prej (-) 2.684.100 lekësh [nga 13 milionë lekë] për krijimin e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

12.22. Po ashtu, në kushtet që trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi të paprovuara nga dokumentacioni në fashikull dhe të pamundura të zbardhen dyshimet e Komisioneres Publike/Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme mbi vërtetësinë e çmimit të shitjes së pasurive dhe ligjshmërinë e të ardhurave nga shitja e tyre, në këtë fazë dhe në një proces administrativ, ky aspekt nuk u bë pjesë e vlerësimit tërësor të çështjes, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe nën dritën e nenit 61, pika 5 e këtij ligji.

I./4 Vlerësimi në lidhje me analizën financiare

13. Komisioni ka konkluduar se nga analiza e treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1992 - 2016, konstatohet një balancë negative fondesh në total prej (-) 986.669 lekësh e konkretisht, në vitin 2011 në vlerën (-) 393.160 lekë dhe në vitin 2014 në vlerën (-) 593.509 lekë. Kjo balancë negative e shpërndarë në dy vite, u vlerësua e pamjaftueshme për ta vënë subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe këto balanca negative nuk ndikojnë drejtpërdrejt në burimin e krijimit të pasurive të subjektit e, për rrjedhojë, nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të çështjes.

13.1. Komisionerja Publike pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës të rezultatit të hetimit mbi burimet e ligjshme dhe pamjaftueshmërinë financiare në vlerën rreth 3.400.000 lekë të konstatuar për vitet 2011, 2014 dhe 2015. Ajo potencon konkretisht se: (i) të ardhurat e pretenduara nga *shitja e një gjeneratori në vitin 2011*, nuk mund të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive dhe mbulimit të shpenzimeve për vitin 2011, për shkak se këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore dhe atë *vetting*, sikurse ka pranuar edhe vetë subjekti në përgjigjet e procesverbalit të ILDKPKI-së, datë 11.02.2015; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar *shpenzime shkollimi* vetëm në DIPP-2013, dhe jo në vitet në vijim, 2014, 2015 e 2016, në mosrespektim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, për deklarimin e shpenzimeve të deklarueshme me vlerë mbi 300.000 lekë. Për rrjedhojë, subjekti ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë, në lidhje me shpenzimet e shkollimit.

13.2. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare, konfirmoi se mban të njëjtin qëndrim me atë të shprehur në ankim dhe në parashtrime dhe parashtrori që subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3, i lidhur me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Ai potencoi në fjalën përfundimtare që: (i) Pretendimi i subjektit se shuma prej 1.300.000 lekësh nga shitja e gjeneratorit, nuk është e ardhur personale, por familjare, është i pambështetur në akte. (ii) Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzime shkollimi vetëm në deklaratën për vitin 2013, ndërsa shpjegimet e tij në Kolegj se pagesat

e identifikuara nga llogaria bankare pasqyrojnë detyrime dytësore administrative dhe lëvizje periodike të lidhura me procesin arsimor, janë deklarative e nuk mbështeten në dokumentacionin e institucionit arsimor që ndjek i biri në Zvicër. Nuk ka të dhëna për çfarë ekzaktësisht mbulon shkolla. (iii) Mbeti deklarativ pretendimi i subjektit mbi mungesën e detyrimit për deklarim dhe se shpenzimet e paguara kanë qenë nën pragun e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003. (iv) Subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi burimet e ligjshme dhe pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar nga Komisioni për vitet 2011, 2014 dhe 2015, në vlerën rreth (-) 3,4 milionë lekë për këto vite. (v) Edhe pas shqyrtimit në Kolegj, mbetën të paezuaruara dyshimet mbi ligjshmërinë e të ardhurave nga shitja e tokës me sipërfaqe prej 1.750 m², në vlerën prej 210.000 eurosh, në zbatim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

13.3. Subjekti i rivlerësimit ka prapësuar në tërësi konkluzionet e mësipërme. Në mënyrë të përmbledhur, përpos sa është përmbledhur e analizuar më sipër, ai theksoi se:

(i) Të ardhurat nga shitja e gjeneratorit në vitin 2011, janë të ligjshme, të dokumentuara, të integruara në shtesën e bonove të thesarit, sipas deklarimit. Transaksioni është pasqyruar me të njëjtin përshkrim në depozitim bankar të datës 8 prill 2011, ku ka identifikuar edhe blerësin/një shoqëri me aktivitet shitje gomash. Ky fakt është deklaruar edhe në ILDKPKI, në procesverbalin përkatës, i cili duhet pranuar si provë gjatë procesit të rivlerësimit. Ndryshimet terminologjike brenda zërit “të ardhura familjare”, nuk cenojnë ligjshmërinë e kësaj të ardhure.

(ii) Për sa u përket shpenzimeve të arsimit, dokumenti i pranimit në shkollë [Enrollment Confirmation datë 18.12.2023] i institucionit arsimor⁶¹ që ka ndjekur i biri, vërteton statusin student me bursë të tij gjatë gjithë periudhës gusht 2013 - qershor 2016. Ky institucion arsimor operon si shkollë konvikti dhe modeli i tij tarifor përfshin arsimimin dhe akomodimin. Kjo provë direkte e bën metodën “ekstrapoluese, Eurostat + tarifë”, jopërfaqësuese për vitet 2014 - 2015, pasi presupozon shpenzime jetese familjare të cilat, në rastin konkret, mbulohehin nga shkolla dhe bursa. Transfertat në llogarinë bankare të subjektit, pasqyrojnë detyrime dytësore administrative dhe lëvizje periodike të lidhura me procesin arsimor, por jo pagesë të kryer nga familja e tij për tarifën neto të shkollës dhe për kostot e qëndrimit. Subjekti i kërkoi Kolegjit një vlerësim të posaçëm të disa akteve të sjella prej tij⁶² në mbështetje të këtyre pretendimeve.

13.4. Subjekti pretendon se e gjithë analiza financiare i referohet periudhës jashtë intervalit kohor të rivlerësimit dhe, në çdo rast, jashtë ushtrimit të funksioneve publike nga ana e tij. Pretendimet për pasaktësi nuk duhet të përkthehen në dyshime për përfitim nga funksioni publik. Nën dritën e parimit të proporcionalitetit, pasaktësitë jashtë periudhës së rivlerësimit nuk mund të përdoren si indicie për abuzim me detyrën. Pasuritë e ankmuara janë krijuar përpara marrjes së funksionit dhe, për më tepër, i përkasin familjes së tij të origjinës e janë përfituar prej tij me trashëgimi, si i vetmi trashëgimtar. Kjo rrethanë trashëgimie që u jep pasurive një karakter të dallueshëm nga të ardhurat e lidhura me funksionin publik, duhet marrë në konsideratë dhe vlerësuar nga Kolegji nën dritën e disa rrethanave, si: (i) deklarimet e vazhdueshme që nga viti 2015; (ii) aktet e trashëgimisë; (iii) pamundësinë

⁶¹ {***} in Switzerland.

⁶² Konkretisht: (i) “Enrollment Confirmation”, datë 18.12.2023, që konfirmon statusin student me bursë per 2013 - 2016; (ii) të “{***}” të Georgetown, që pasqyrojnë grantet 55.801 USD (2020-2021) dhe 70.768 USD (2021-2022) dhe “{***}” 3.200 USD; si dhe (iii) ekstraktet bankare ku pagesat “inv academic year”, sipas tij, u korrespondojnë detyrimeve dytësore.

objektive të rikuperimit të dokumentacionit financiar pas shumë vitesh, dhe (iv) jurisprudencën e Kolegjit se pasaktësitë në deklarime të pashoqëruara me mungesë burimesh të ligjshme, nuk mund të përkthehen në përgjegjësi disiplinore të subjektit.

13.5. Përpos sa ka arsyetuar në detaj më sipër për të gjitha shkaqet ankimore, trupi gjykues i Kolegjit u ndal edhe në analizën e kryer për të vetmet shpenzime shkollimi për të cilat kishte shkak ankimi⁶³. Nga aktet në fashikull, rezulton se në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar shpenzime shkollimi për fëmijët e tij. Për arsimimin e njëri prej djemve, për të cilin ngrihet shkaku i ankimit, subjekti ka deklaruar se në periudhën objekt vlerësimi 2012⁶⁴ - 2016, ka kryer shpenzime arsimit si vijojnë: (i) në vitin 2012 - 2013 ka paguar shumën 1.100 euro për përfundimin e klasës së nëntë në kolegjin arsimor “{***}”; (ii) në vitet 2013 - 2016 ka shpenzuar shumën 17.639 CHF/ekuivalenti i 2.020.195 lekë për studimet në Zvicër, ku i biri, sipas tij, kishte fituar bursë të plotë – që mbulon çdo shpenzim për shkollimin dhe jetesën. Nga shuma e paguar për semestrin e parë të vitit të parë, shkolla i ka kthyer shumën 5.351 CHF me transfertën bankare të datës 13 tetor 2016; (iii) në vitin 2014 ka shpenzuar shumën 4.200 CHF/ekuivalenti i 489.426 lekë; (iv) në vitin 2015 shpenzoi shumën 3.900 CHF/ekuivalenti i 495.885 lekë; (v) dhe në vitin 2016 shumën 3.200 CHF/ekuivalenti i 402.560 lekë. Sipas shpjegimit, shpenzimet për këto vite janë bërë më shumë për udhëtime të ndryshme që djali i tij ka kryer gjatë periudhës në fjalë.

13.6. Nga sa më sipër, rezulton se shpenzimi i vitit 2012 ka qenë nën kufirin e deklarueshëm në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ndërsa shpenzimet për vitet në vijim, 2013-2016, ishin mbi vlerën e detyrueshme për deklarim. Ndryshe nga sa pretendohet në ankim, trupi gjykues vëren se nga aktet e depozituara në Komision, rezulton e provuar se shpenzimet e këtyre viteve nuk janë përballuar nga familja e subjektit. Konkretisht, dokumenti i pranimit në shkollë, i datës 18.12.2023, konfirmon dy rrethana thelbësore: faktin që djali i subjektit është regjistruar me *bursë të plotë* për periudhën 2013 – 2016 dhe që ky institucion arsimor funksionon si një *shkollë me konvikt*. Në këto kushte, subjekti nuk mund të konsiderohet se ka kryer deklarim të pasaktë e të pamjaftueshëm sipas pretendimit të ankuesve.

13.7. Në përmbyllje të pretendimeve të potencuara në lidhje me analizën financiare, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në kushtet që subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion të kohës *përfitimin e bursës së plotë*, konstatimi i Komisionit për të mos i ngarkuar shpenzime për këtë zë, analizës financiare për vitet 2014 e në vijim, është i drejtë. Edhe pas këtij korrektimi, sikurse edhe të tjerëve të arsyetuar më sipër, subjekti i rivlerësimit rezultoi me një balancë negative në vlerë të konsiderueshme. Totali i balancës negative i rezultuar në Kolegji për të gjithë periudhën e analizuar, 1992 – 2016, rezultoi në vlerën (-) 13.576.864 lekë.

13.8. Nga ana tjetër, trupi gjykues çmon të theksojë se pretendimi i subjektit për të zbatuar parimin e proporcionalitetit meqenëse ai është emëruar prokuror në vitin 2015, u vlerësua i pabazuar. Subjekti i rivlerësimit ka qenë në vijimësi i punësuar në institucione që financohen nga buxheti i shtetit dhe duke filluar nga viti 2005, kur është emëruar Oficer i Policisë Gjyqësore, ka qenë edhe pjesë e sistemit të drejtësisë; më pas për një periudhë kohore, subjekti është punësuar në ILDKPKI, për kontrollin e pasurisë së funksionarëve publikë. Në këto rrethana, duke pasur parasysh natyrën e

⁶³ Pretendimet e Komisioneres Publike janë vetëm në drejtim të shpenzimeve të shkollimit për djalin B. Ç.

⁶⁴ Viti në të cilin lindi detyrimi për deklarimin e shpenzimeve.

pamjaftueshmërisë financiare të burimeve të ligjshme apo vlerën e tyre, faktin që subjekti ka qenë në mënyrë të vazhdueshme funksionar publik dhe i sistemit të drejtësisë, qenia e tij në pozicione të tjera përpara vitit 2005, e bën njësoj të qenësishëm standardin e kërkuar nga një magjistrat për integritet⁶⁵.

14. Në përfundim të verifikimeve të kryera për kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit *ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme* për krijimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, nën dritën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit *nuk arrin* nivelin e besueshmërisë në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas përcaktimit të shprehur të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

II. Vlerësimi për kriterin profesional dhe tërësor të çështjes

15. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka argumentuar bindshëm gjetjet e evidentuara nga shqyrtimi i denoncimeve të publikut dhe i çështjeve të tjera penale. Në vlerësimin tërësor, sipas Komisionit, nuk u konstatuan rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, që mund të çojnë në konkluzione negative për kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale. Në vlerësimin e përgjithshëm, nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze, apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Komisioni ka vlerësuar përfundimisht, se subjekti ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016. Ndërsa, për procedimin penal nr. {***/2019, me të pandehur M. A. etj., Komisioni vlerësoi se duhet të transferohet për inspektim pranë ILD-së.

15.1. Ndër dosjet penale të shqyrtuara nga Komisioni, Komisionerja Publike parashtron shkaqe ankimi në lidhje me dy (2) prej tyre. Konkretisht, Komisionerja Publike pretendon se: (i) Në konsideratë të indicieve të institucioneve të verifikimit dhe raportit të DSIK/AKSIK-ut, gjetjet në procedimin penal nr. {***/2019, në ngarkim të të pandehurit M. A., nuk duhen transferuar për inspektim pranë ILD-së, por duhen bërë pjesë e *vlerësimit tërësor* të çështjes në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ku *më së paku*, duhen vlerësuar në drejtim të indikatorëve të aftësive profesionale të prokurorit, parashikuar në nenet 73, pika 3 dhe 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016. (ii) Nën të njëjtën linjë arsyetimi, Komisionerja Publike i kërkon Kolegjit të bëjë pjesë të vlerësimit tërësor edhe *procedimin penal nr. {***}, datë 18.06.2019*⁶⁶, me argumentin se provohet që subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrat e lëna nga Gjykata. Këto veprime afektojnë kriterin e aftësisë profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 3, nenin 74, pikat 2 dhe 4 dhe nenin 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016. (iii) Problematikat e mësipërme duhen trajtuar nga Kolegji eventualisht, së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si situata që *mund të ndikojnë në cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

15.2. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare, konfirmoi të njëjtin qëndrim me atë të shprehur në ankim dhe në parashtrimet e datës 05.11.2025. Bazuar në dy

⁶⁵ Shih: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-208053>, paragrafi 407, vendimi i GjEDNj-së në çështjen *Xhoxhaj k. Shqipërisë*, referuar edhe në çështjen *A. Zeneli k. Shqipërisë* në <https://hudoc.echr.coe.int/?i=001-247590>.

⁶⁶ Të shqyrtuar nga Komisioni në kuadër të denoncimit të znj. S. P.

procedimet penale objekt i shkaqeve të ankimit, ai potencoi se veprimet e subjektit të rivlerësimit afektojnë kriterin e aftësisë profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 3, nenin 74, pikat 2 dhe 4, si dhe nenin 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016. Problematikat e konstatuara në këto dy çështje duhen trajtuar në kuadër të aplikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Në çështjen e parë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të argumentojë arsyet që çuan në ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për dy të pandehur dhe kërkesën për pushimin e hetimeve për dy nga personat nën hetim, duke minimizuar rëndësinë e faktit penal dhe rrezikshmërinë e veprës penale. Sa i përket çështjes penale të dytë, ardhur në analizë për shkak të denoncimit [nga znj. S. P.], subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës për mospërbushjen e detyrave të lëna nga Gjykata. Ai ka treguar mungesë në respektimin e afateve ligjore, të aftësisë për të kryer me efekt procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë, referuar indikatorëve të përcaktuar nga neni 74, pikat 2 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016.

15.3. Subjekti i rivlerësimit ka prapësuar në tërësi argumentat e sipërpërmbledhura. Ai dha shpjegime për dy procedimet penale të ankimuara, duke potencuar në mënyrë të përmbledhur se ka kryer hetime të plota dhe ka përmbushur në mënyrë ezauruese detyrat e lëna nga gjykata.

15.4. Trupi gjykues çmon të theksojë se kërkimi i ankimit dhe i bisedimeve përfundimtare, përmbledhur më sipër, fokusohet në vlerësimin tërësor të subjektit dhe jo si pjesë e vlerësimit të kriterit profesional. Rrethanat e konstatuara nga shqyrtimi i dy procedimeve penale, në vlerësimin e Kolegjit, rezultuan të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës apo që ai nuk arrin nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas kërkesave të nenit 59, pika 1, gjerat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016. Rrethanat që rezultojnë nga këto dosje penale, nuk mund të argumentohen si një mënyrë sjelljeje e subjektit të rivlerësimit që ka cenuar të drejtat e palëve. Për rrjedhojë, mangësitë që u vunë re, nuk u konsideruan se mund të cilësohen se cenojnë besimin e publikut te drejtësia, në kushtet që problematikat e potencuara nga Komisionerja Publike e të konfirmuara nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për kriterin e vlerësimit profesional, u vlerësuan ndryshe nga trupi gjykues i Kolegjit, duke mbajtur në konsideratë gjithë aktet në fashikull. Ky konkluzion u bazua në analizën që shtjellohet në vijim.

15.4.1. Procedimi penal në ngarkim të të pandehurve *M. A. e të tjerë* [nr. {***/2019}], kishte për objekt hetimin e një vepre penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit kishte disponuar me lehtësim të kualifikimit ligjor për dy të pandehur dhe pushimin e çështjes për dy të tjerë. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton mungesë arsyetimi në vendimin e Komisionit, i cili konsiston kryesisht në parashtrimin e rrethanave të hetimit dhe evidentimin e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale për dy të pandehur dhe pushimin e çështjes për dy të tjerë. Përpos relatimit, Komisioni nuk rezulton të ketë analizuar nëse subjekti i rivlerësimit ka lehtësuar pozitën e të pandehurve në shkelje të dispozitave materiale e procedurale. Po ashtu, Komisioni nuk ka bërë asnjë vlerësim konkret nën dritën e kriterit të aftësive profesionale, të figurës apo besueshmërisë së subjektit në sytë e publikut, në vlerësimin tërësor të çështjes.

15.4.2. Në të njëjtën linjë, edhe bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme u fokusuan në argumentimin që çështja nuk duhet të ishte transferuar pranë ILD-së, pa sjellë një analizë të veprimeve të subjektit që janë të pabazuara, apo në shkelje të indikatorëve të ligjit nr. 96/2016. Të

dy këta subjekte procedurale, nuk kanë parashtruar përse, sipas tyre, subjekti ka minimizuar rëndësinë e faktit penal dhe rrezikshmërinë e veprës penale e, gjithashtu, nuk parashtrojnë një analizë të fakteve konkrete që provojnë ekzistencën e rrethanave që duhen bërë pjesë e vlerësimit tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

15.4.3. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit *nuk* konstatoi shkelje të rënda procedurale, gabime thelbësore e serioze në kryerjen e hetimeve dhe as mangësi me peshë në drejtim të nënindikatorëve të vlerësimit profesional në kuptim të neneve 73-75 të ligjit nr. 96/2016. Po ashtu, trupi gjykues *nuk* konstatoi elemente që mund të afektojnë indikatorët e aftësive profesionale, sikurse zvarritje të hetimit, paplotësi veprimesh hetimore, tejkalime kompetencash, prani e ndonjë situatë konflikti interesi, apo mungesë arsytimi ligjor, në aktet e disponuara prej subjektit.

15.4.4. Nga ana tjetër, nga aktet në fashikullin penal, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsytuar edhe shkaqet që diktuan ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për dy të pandehur dhe pushimin e çështjes për dy të tjerë me urdhrin e datës 15.12.2019. Pyetja nëse ky ndryshim është në përputhje me provat, u vlerësua nga Kolegji se do të kërkonte vlerësimin e tyre [provave], që përbën një aspekt të lidhur ngushtë me korrektësinë e vendimmarrjes së prokurorit. Për pasojë, mund të gjejë zbatim ndalimi nga pika 4 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, për mosndërhyrjen e vlerësuesit në logjikën e interpretimin e të vlerësuarit.

15.4.5. Së fundmi, ndonëse konstatoi mosrespektimin nga subjekti të detyrimit për të informuar drejtuesin e prokurorisë për zhvillimet me peshë përcaktuese në këtë procedim penal, sipas kërkesave të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm⁶⁷ nr. 8/2019, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky fakt mund të marrë peshë, nëse do ishte në harmoni me indicie të tjera që tregonin veprime qëllimisht neglizhente në një procedim penal.

15.5. Për procedimin tjetër penal [nr. {***}/2019] të analizuar si pasojë e një denoncimi nga znj. S. P., trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se fokusimi i subjektit vetëm tek afatet e parashkrimit të ndjekjes penale dhe jo në zgjidhjen e pasojave ligjore që prodhuan aktet e hetuara apo autorëve të mundshëm të saj, që përbënte edhe shqetësimin real të denoncuesit e konstatuar nga kontrolli gjyqësor, e afekton kriterin e aftësisë profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar nga neni 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016. Në këtë vlerësim, trupi gjykues u bazua në analizën që rezulton nga vendimi i parë i gjykatës [nr. {***}, datë 30.09.2020], përmes të cilit prokurori/subjekti urdhërohet të kryejë hetime të caktuara. Vendimi i dytë gjyqësor për këtë çështje [nr. {***}, datë 07.07.2022], përmes të cilit subjekti është urdhëruar sërish për të kryer hetime, nuk mund të jetë objekt kontrolli në Kolegji, pasi ai është ankimuar nga subjekti dhe ende ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Kolegji nuk mund të përdorë argumentet e vendimit të dytë të gjykatës, sa kohë që ai është ende nën shqyrtim gjyqësor.

⁶⁷ Ky udhëzim, në nenin 12, pikat 6 dhe 8, përcaktonte: “6. Prokurori informon paraprakisht drejtuesin e prokurorisë rreth vendimit të tij për ngritjen e akuzës apo pushimin e saj, kur procedohet për krime dhe/ose kundërvajtje penale.[...] 8. Prokurori duhet të njoftojë paraprakisht drejtuesin e prokurorisë në rastet kur administrohen prova lidhur me rrethana që lehtësojnë pozitën e të pandehurve dhe/ose personave nën hetim.[...]” Po aty, në nenin 15, pika 4, parashikohet se: [...] 4. Në rastet kur gjykata nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit lidhur me deklarinimin e fajësisë, cilësimit juridik të veprës, caktimin e llojit dhe/ose masës së dënimit apo caktimin e masës së sigurimit personal, apo pasuror etj., prokurori menjëherë ose jo më vonë se brenda 2 (dy) ditëve informon drejtuesin e prokurorisë nëse do të ushtrojë apelim kundër vendimit të gjykatës [...]”.

15.5.1. Nga aktet në fashikull, trupi gjykues konstaton se, pas kthimit të akteve nga gjykata, subjekti ka zbatuar udhëzimet për plotësimin e hetimeve, siç rezulton nga kërkesa e datës 13.10.2021 për pushimin e çështjes. Në këtë akt, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të urdhëruara nga gjykata me përjashtim të marrjes së një kontrate nga noteri, për të cilën është mjaftuar vetëm me evidentimin e faktit që ai kishte ndërruar jetë. Përkundër këtyre veprimeve, në këtë kërkesë [njoftuar kallëzuesit D. P. në datën 14.10.2021], vërehet se pavarësisht se ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit të veprave penale të kallëzuara, subjekti i rivlerësimit ka evidentuar që regjistrimi i pronës në emër të së kallëzuarës ishte kryer në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi ajo nuk ka qenë subjekt i ligjit nr. 7501 “Për token”.

15.5.2. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se këto mangësi nuk e kanë cenuar kallëzuesin në mbrojtjen apo rivendosjen e së drejtës. Me njohjen me kërkesën për pushimin e çështjes⁶⁸, denoncuesi është njohur me arsyetimin e prokurorit për AMTP-në dhe prezumohet se kishte mundësi të shfrytëzonte mjetet e tjera ligjore për të kërkuar pavlefshmërinë e akteve të kontestuara, të referuara në kërkesën e subjektit për pushimin e çështjes. Për rrjedhojë, mangësitë e sipërpërmendura vlerësohen të pamjaftueshme për ta konsideruar subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm profesionalisht, apo passjellë aplikimin e masës disiplinore.

15.6. Në përfundim të kontrollit të vendimit të Komisionit objekt ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se:

15.7. Subjekti i rivlerësimit *ka mungesë* të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

15.8. Rrethanat e konstatuara nga shqyrtimi i dy procedimeve penale janë të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës apo që nuk arrin nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas kërkesave të nenit 59, pika 1, germat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016. Në vlerësimin tërësor të procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, veprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shitblerjen e dy pasurive tokë apo dy procedimet penale, nuk janë të mjaftueshme që të ngrihen në nivelin e cenimit të besimit të publikut të drejtësia, veçmas e në mënyrë autonome.

16. Nën dritën e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivelin e besueshmërisë në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Për rrjedhojë, vendimi nr. 738, datë 22.02.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i pabazuar në fakte dhe në ligj e duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

⁶⁸ Me shkresën nr. {***} prot., datë 14.10.2021, bashkëlidhur denoncimit.

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 738, datë 22.02.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gëzim Çopa.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 16.12.2025.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi